




KOMUNA E LIPJANIT

RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)

RAPORT I VSM PËR PZHK TË KOMUNËS SË LIPJANIT



RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)

RAPORT I VSM PËR PZHK TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Autor:

Eco – Iliria
Adresa: Bedri Shala, Prishtinë
Mob.: +383 (0) 44 662 946
E-mail: tush_beta@yahoo.com

Investitor:

Komuna e Lipjanit

Lipjan, 2023

RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)

RAPORT I VSM PËR PLAN ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Kryetar i Komunës së Lipjanit:
Z. IMRI AHMETI

*Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit
Hapësinor, Komuna e Lipjanit:*
Z. IMRI SEMETISHTI

*Menaxhere e projektit të hartimit të VSM të PZHKs
te Komunës së Lipjanit e caktuar nga Komuna e
Lipjanit:*
Znj. HANUSHE BERISHA

*Menaxher i projektit të Hartimit të VSM të PZHKs
të Komunës së Lipjanit, i caktuar nga konsorcimi i
kontraktuar:*
Z. TUSH MARKAJ, (NTP. ECO ILIRIA)

*Hartues i Raportit të VSM
Tush markaj Senior expert i M se
Mjedisit
Pellumbe Gjinolli Msc Ing
.Mjedisit
Lush Tunaj Biolog expert i
Licensuar VNM
Luigj Markaj Junior expert*

Lipjan, 2023



LISTA E SHKURTESAVE

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal

VSM –Vlersimi Strategjik Mjedisore

AKMM - Agjencia Kosovarë për Mbrojtjen e Mjedisit

BE - Bashkimi Evropian

GIS – Sistemi i Informacionit Gjeografik

GNP - Grimcat e Ngurta Pezull

ISN – Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar

ISHPKZh- Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim

MMPHT – Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Transport

NOQ - Ndotsë Organike të Qëndrueshem

NTPH- Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ - Organizata Jo Qeveritare

OZHM - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PRRH – Plani Rregullues i Hollësishëm

SAP- Sipërfaqja Absorbuese e Parcelës

SGJAP – Sipërfaqja Gjellbëruese e Absorbuese e Parcelës

SGJP – Sipërfaqja Gjellbëruese e Parcelës

TeR - Termat e Referencës

UA- Udhëzimi Administrativ



UNDP - Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP - Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara

VBJ – Vendbanime jo Formale

VN- Vija Ndërtimore

VNM - Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VNN- Vija Ndërtimore Ndihmëse

VR- Vija Rregulluese

ZVM - Zona e Veçanta e Mbrojtura

**Lista e figurave**

Figura 1. Pozita gjeografike e komunes se Lipjanit.....	23
Figura 2. Karakteristikat Gjeologjike.....	27
Figura 3. Infrastruktura rrugore.....	33
Figura 4. Shtrirja e rrjetit te kanalizimit.....	35
Figura 5. Shtrirja e rrjetit elektrik.....	39
Figura 6. Trashegemia kulturore.....	40
Figura 7. Koncepti i zhvillimit hapsinor – Skenari I.....	47
Figura 8. Skenari II – zhvillimin e komunes si nje qender monocentrike.....	48
Figura 9. Skenari II Zhvillim policentrik.....	49
Tabela 1. Rezervat e mineraleve.....	29
Tabela 2. Shuma mesatare vjetore dhe mujore e shkelqimit diellor ne ore.....	30
Tabela 3. Shpejtesia mesatare e eres sipas muajve dhe vitit.....	30
Tabela 4. Zonat Veçanta të Mbrojtura sipas sipërfaqeve (ha) të shtrirjes në zona kadastrale.....	41
Tabela 5. Zonat e veçanta të mbrojtura.....	41
Tabela 6. Sektorët ekonomik dhe struktura e tyre(sipas PZHK).....	43
Tabela 7. Tabela e Indetifikimit te Ndikimeve Mjedisore per Cdo Prioriteti dhe Faktori Mjedisor(√: Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor, X: nuk ka efekt të Prioritetit në faktorin mjedisor).....	70
Tabela 8. Problemet me te rendesishme mjedisore ne komune.....	73
Tabela 9. Plani monitorimit.....	76



Permbajtja

1. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE	10
2. HYRJE DHE PROCEDURA PËR VSM.....	11
2.1. Hyrje dhe procedura e VSM-së	11
2.2. Informacion i përgjithshëm për VSM.....	12
2.2.1. Përkufizime për VSM	12
2.2.2. Rëndësia e VSM	13
2.2.3. Problemet në zbatimin e VSM.....	17
3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	18
3.1. Direktiva VSM e BE-së	18
3.2. Direktiva të tjera të BE-së.....	18
3.3. Strategjia 2020 e BE-së.....	19
3.4. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB.....	19
3.5. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	20
3.6. Konventa ESPOO dhe Protokolli i Kievit	20
3.7. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse	21
3.8. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)	21
4. GJENDJES EKZISTUESE – ANALIZA	21
4.1. Pasqyra e përgjithshme	21
4.2. Struktura topografike	24
4.3. Malet dhe fushat.....	24
4.4. Rrafshinat	24
4.5. Pjerrtësia	24
4.6. Lumenjtë dhe sipërfaqet tjera ujore	25
4.7. Struktura gjeologjike	25
4.8. Burimet minerale	27
4.9. Kushtet klimatike.....	29
4.10. Vlerat natyrore.....	30
4.11. Mënyra e shfrytëzimit të tokës	30



4.12. Erozioni.....	31
4.13. Trashëgimia natyrore	31
4.14. Transporti dhe infrastruktura.....	32
4.15. Ujësjiellësi.....	33
4.16. Kanalizimi.....	34
4.17. Trajtimi i ujërave të ndotura.....	35
4.18. Menaxhimi i mbeturinave	37
4.19. Furnizimi me Energji Elektrike	38
4.20. Trashëgimia kulturore.....	38
4.21. Zonat e Veçanta të Mbrojtura.....	40
4.22. Profili demografik.....	40
4.23. Struktura ekonomike.....	41
4.24. Bujqësia.....	42
4.25. Turizmi.....	43
5. VLERËSIMI MJEDISOR I SKENARËVE ZHVILLIMORË	44
6. PËRSHKRIM I PËRGJITSHËM I PLANIT	49
6.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit	49
6.2. Arsytimi Ligjor, Mjedisor, Ekonomik, Financiar Dhe Social	50
6.3. Konkluzionet rreth kontekstit mjedisor	52
7. PARIME, OBJEKTIVE E KRITERE MJEDISORE	54
7.1. Objektivat e VSM-së për PZH Komunale të Lipjanit	54
7.2. Projekt-Raporti perfundimtar	56
7.3. Roli dhe natyra e Planit Zhvillimor Komunal	57
7.4. Identifikon lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të komunës.....	58
7.5. Kriteria të forta mjedisore-shëndetësore	58
7.5.1. Zonat e mbrojtura	58
7.5.2. Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:.....	59
7.5.3. Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike) përfshijnë:	59
7.6. Kriteria të trashëgimisë kulturore	60
8. NJOHJA DHE PARASHIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE	60



8.1. Ndikimet mjedisore	60
9. PERCAKTIMI I OBJEKTIVAVE TE VSM-së	72
9.1. Problemet mjedisore dhe objektivat e VSM-së që rrjedhin prej tyre	74
10.MONITORIMI	75
10.1. Plani i Monitorimit	75
LITERATURA	80



1. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Proçesit të Vlerësimi Strategjik Mjedisor i nënshtrohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunale të komunës së Lipjanit. VSM hartohet në zbatim të detyrim ligjor, i cili parashihet në nenin 23 të Ligjit të Planifikimit Hapësionor nr. 04/L-174. Metodolgjia e cila është përdorur në këtë VSM është në perputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC, mbi vlerësimin e efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis dhe ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë, i cili është transpozimi i direktivës së BE 2001/42/EC. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një studim mjedisor, i cili vlerëson ndikimet në mjedis dhe në veçanti, në tokë, ajër, ujë, klimë, florë dhe faunë, në mbeturina, mjedisin akustik / zhurmat, në popullsi dhe asete, kulturë (qendrat arkeologjike, monumentet, etj.) dhe në peizazh. Por meqënëse studimi VSM ka karakter strategjik dhe vlerëson Objektivat Strategjike dhe Akset Prioritare të propozuar, nuk i referohen detajeve apo projekteve të veçanta, të cilat janë vlerësuar për ndikimin e tyre në mjedis në studimet e tjera të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis.

Për ndikimet mjedisore të identifikuar si negative, Studimi i Vlerësimit Strategjik të Ndikimeve Mjedisore propozohen masat për perballimin e tyre, të cilat janë kryesisht parandaluese dhe kanë të bëjnë me masat strategjike dhe jo me masa të hollësishme, pasi ato janë subjekt i Studimeve të Ndikimit në Mjedis. Shënohet se Studimet e Ndikimit në Mjedis që do të përgatiten në të ardhmen për projekte të ndryshme të propozuara të infrastrukturës teknike apo projekte të zhvillimit në zonën e komunës së Lipjanit, duhet të marrin parasysh Vlerësimin Strategjik Mjedisore (VSM), për të qenë më efektiv në identifikimin, parashikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore të projekteve si dhe formulimin e masave për të trajtuar këto ndikime mjedisore. Konkluzioni i Studimit të Vlerësimit Strategjik në Mjedis është se ndikimet negative janë të kufizuara në faktorë të veçantë të mjedisit (tokës, ujit, biodiversitetit, mbeturinave, mjedisit akustik / zhurmave dhe peizazhit), ndërsa ndikimet pozitive të Projektit për PZHK të komunës së Lipjanit të propozuar janë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me të gjithë faktorët e mjedisit. Nga fillimi i draftimit të propozimeve të tij, plani ka marrë parasysh kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm, duke integruar aspektin mjedisor në mbrojtjen dhe



përmirësimi e mjedisit natyror, kulturor dhe njerëzor në si objektiv strategjik me prioritet. Nga fillimi, plani kishte orientim miqësor me mjedisin, dhe për këtë arsye nuk është për t'u habitur që në vlerësimin e ndikimeve mjedisore të tij, shumë ndikime pozitive dhe negative shpesh varen nga mënyra e zbatimit të planit dhe jo direkt nga rekomandimet e planit.

2. HYRJE DHE PROCEDURA PËR VSM

2.1. Hyrje dhe procedura e VSM-së

Ky studim VSM ka për qëllim vlerësimin e mjedisit të komunës së Lipjanit dhe hartohet në zbatim të ligjit Ligji Nr. 03/L-230 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", i cili është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedisë" të përshkruar si në vijim:

Së pari realizohet një konsultim paraprak me grupet e interesit, ku paraqiten

- a) koncepti i Vlerësimit Strategjik të Ndikimit në Mjedis,
- b) procedurat për aplikimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor,
- c) faktorët e rëndësishëm mjedisorë që pritet të preken nga propozimet e PZHK dhe
- d) realizohet diskutim me qëllim që palët e interesit të shprehin pikëpamjet e tyre mbi ndikimin mjedisor dhe të regjistrohen shqetësimet e tyre në lidhje me çështjet e mjedisit.

Në vazhdim përgatitet dhe dorëzohet Vlerësimi Strategjik Mjedisor (buletin dhe harta shoqëruese), me strukturën dhe përmbajtjen, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Realizohet konsultim në lidhje me gjetjet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në lidhje me ndikimin mjedisor të komunës së Lipjanit, e cila në mënyrë procedurale realizohet paralelisht me konsultimet me publikun. Së fundi, duke marrë parasysh gjetjet dhe rezultatet e dy konsultimeve - të VSM - hartohet Vlerësimi përfundimtar Strategjik Mjedisor të Komunës së Lipjanit.



2.2. Informacion i përgjithshëm për VSM

2.2.1. Përkufizime për VSM

Një nga vizionet më moderne për vlerësimin e ndikimit në mjedis është institucioni i Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili zbatohet përmes hartimit të një studimi mjedisor, në fazën primare të një plani strategjik zhvillimi, në nivel politik, projekti, programi, domethënë jo të një projekti individual. Ky studim mjedisor quhet Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) dhe në Evropë gjen zbatim vetëm në plane dhe programe - dhe jo në politika - në përputhje me Direktivën 2001/42 KE.

VSM merr parasysh objektivat e përgjithshme të zhvillimit të një vendi apo rajoni, efektet kumulative të planifikimit strategjik të propozuar, problemet globale mjedisore, duke lidhur planifikimin strategjik me to, por edhe gjithë çështjet e tjera të zhvillimit të qëndrueshëm, për të cilat janë zhvilluar strategji evropiane dhe kombëtare dhe janë vendosur objektiva konkrete p.sh. reduktim të ndotësve serë, menaxhim të integruar të burimeve ujore në nivel baseni, menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, etj.

VSM është një proces sistematik dhe gjithëpërfshirës i vlerësimit të ndikimeve mjedisore të një politike, të një plani apo programi, duke përfshirë një raport me rezultatet e konsultimeve me grupet e interesit dhe me konkluzionet e studimit, me qëllim për të ndihmuar në vendimmarrje të një planifikimi strategjik (Therivel dhe Partidario, 1996).

Përkufizime të tjera të rëndësishme që janë dhënë në literaturën ndërkombëtare janë paraqitura si ne vijim:

VSM është një vlerësim i parë i skenarëve alternativë dhe i propozimeve që kanë lidhje me planet e propozuara apo tashmë të miratuara, me programe dhe politika, në kuadër të një vizioni më të gjerë strategjik mjedisor dhe të një sërë objektivash që duhen plotësuar. Qëllimi është që ky vlerësim të drejtojë për nga përzgjedhja e alternativave më të mira, me qëllim që në planifikim të arrihet efekti i dëshiruar (Noble, 2000).

VSM përbën një proces kompleks dhe të strukturuar, që ka si qëllim vlerësimin e ndikimit në mjedis të propozimeve strategjike (të politikave, planeve, programeve) dhe propozimin e masave të mundshme për të trajtuar ose ndaluar efektet apo masat të karakterit parandalues për shmangien e shfaqjes së ndikimeve apo nxitjen e ndikimeve/efekteve pozitive të propozimeve



strategjike në mjedis. Ky proces përfshin edhe një raport me shkrim me rezultatet e konsultimeve. Rezultatet e këtij procesi përdoren nga autoritetet kompetente gjatë vendimmarrjes për zbatimin e planifikimit strategjik (Risse et al., 2003).

Ky përkufizim thekson se VSM përbën një proces të tërë - merr pjesë paralelisht me procesin e planifikimit strategjik - dhe nënvizon se rezultatet e VSM merren parasysh në vendimet përfundimtare mbi planifikimin strategjik (Glasson et al., 2012.). Theksohet se ky përkufizim është ndër të parët që është dhënë për VSM dhe mbulon plotësisht objektin e tij, dhe referohet në pjesën më të madhë të punimeve dhe artikujve shkencorë që kanë si objekt VSM.

VSM përbën një mjet të rëndësishëm i cili ndihmon që faktorët mjedisorë të përfshihen në marrjen e vendimeve në nivel strategjik dhe për rrjedhim, ofron një përpjekje efikase në arritjen e qëllimit për një zhvillim të qëndrueshëm (Therivel dhe Partidario, 1996). Siguron integrimin e çështjeve mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes, siguron një kuadër për vazhdimësinë e veprimeve në nivel të propozimeve strategjike, kontribuon në politikën e zgjeruar të planifikimit dhe ka potencial të identifikojë ndikime të mundshme mjedisore që në fazat e hershme, para se të zhvillohen planet strategjike dhe programet (Desmond, 2007).

2.2.2. Rëndësia e VSM

VSM kërkohet që të mbulojë një "boshllëk" të institucionit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve, dmth, VSM kanë mundësinë të mbulojnë disa të meta të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis. (Therivel dhe Partidario, 1996):

VSM janë të dobishme për shkak se ato kontribuojnë në konfigurimin e një kuadri strategjik – plani ose eprogrami - më miqësor për mjedisin, brenda të cilit do të ndërtohen në të ardhmen projekte të ndryshme zhvillimore dhe projektete infrastrukturës (Wood, 2003). Është karakteristike, ndërsa në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shqyrtohen ndikimet mjedisore të një veprimi të planifikuar zhvillimi, me qëllim minimizimin e tyre, me VSM ngrihen pyetje me karakter parandalues, në lidhje me cilat alternativë zhvillimi është më e mirë dhe cilat objektiva duhet të plotësohen në të ardhmen (Noble, 2010).

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis nuk mer parasysh efektet kumulative që rezultojnë nga projekte të tjera dhe aktivitetet në zonën e studimit, të cilat mund të jenë në fazën ndërtimit apo



funksionimit (Glasson et al., 2012), ndërsa VSM kanë mundësinë të vlerësojnë ndikimet kumulative.

VSM kanë mundësi për të vlerësuar në mënyrë mjedisore propozimet alternative të planeve dhe



programeve, në mënyrë që zgjidhet për çdo herë ajo që është më miqësore me mjedisin, ndërsa Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shpesh herë nuk mund të merren me projekte alternative apo masa alternative për trajtimin e ndikimeve, sepse variantet e skenarëve alternativë kufizohen nga hartimi i projektit në nivel strategjik, i cili është paraprirë në kohë (Glassonetal., 2012).

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis shumë herë është i nevojshëm të hartohet në një periudhë kohore të shkurtër, ose përshkak të kufizimeve financiare, ose që të mos vonohet ndërtimi i projektit të propozuar. Kjo ndihmon për të reduktuar materialin e mbledhur të informacionit dhe cilësisë së analizës së tij. Përkatësisht e reduktuar dhe e dobët mund të jetë edhe përfshirja e qytetarëve në procesin Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Glasson et al., 2012). Përkundrazi, VSM për shkakse shqyrtonë planet dhe programet që kanë natyrë strategjike, paraqet plotësinë paraqitjen e të dhënave mbi mjedisin ekzistues.

Nga ana tjetër, kur një VSM është hartuar në fazat fillestare të procedurës së vendimmarrjes dhe i cili përshkruan gjithë potencialin e mundshëm të zhvillimit të një rajoni, përmes planifikimit strategjik të tij, atëherë sigurohen zgjidhje alternative, mirren në konsideratë ndikimet kumulative, sigurohet përfshirja e qytetarëve në këto procedura dhe vendimet për projekte tëveçuara merren përmes një mjedisi parandalues, i cili është paracaktuar përmes VSM (Therivel, 2004). VSM mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e qëndrueshëm, pasi shtrin parimet dhe teknikat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në një nivel më strategjik. Kjo do të nënkuptonte adaptimin e problematikës së parametrave mjedisorë në proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet: të politikave, të planeve dhe të programeve (Arce dhe GULLON, 2000). Si rrjedhim, studiohen pasojat mjedisore dhe masat për ti përballuar ato në nivel strategjik, ndërsa ka dhe transparencë më të madhe në procesin e vendimmarrjes dhe një përfshirje më efektive të qytetarëve. Por që një VSM të mund të përshkruhet si "i qëndrueshëm", duhet të mos ketë si qëllim të vetëm minimizimin e ndikimeve të një plani apo programi në mjedis, por të formësojë veprimet dhe objektivat e tyre, në mënyrë të tillë që ato të plotësojnë kriteret e objektivat afatmesme të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, VSM merr në konsideratë projektet afat-gjatë dhe të një shkalle më të madhe, kështu ai mund



të përqëndrohet në rrugë të ndryshme ose alternative që çojnë në arritjen e objektivave specifike mjedisore të planeve ose programeve. Për më tepër, shqyrtimi i zgjidhjeve alternative nga VSM, sipas Noble (2000), përbën kusht kyç për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, pasi gjatë njohjes së zgjidhjeve alternative, kërkohet përfshirja e elementëve socioekonomike dhe biofizike, por dhe mirëkuptimi i lidhjes së tyre të ndërsjelltë dhe të ndërvuarur. Për të përcaktuar se cilat nga zgjidhjet alternative kanë më shumë gjasa për të kontribuar në qëndrueshmërinë, është e nevojshme të përcaktohen kriteret në bazë të të cilave merren vendimet e zbatimit të planifikimit strategjik.

Këto kriteret janë të lidhura kryesisht me besueshmërinë e procesit të VSM p.sh. në çështjet e konsultimit, por dhe të materialeve të informimit që përdoren. Përveç kësaj, VSM inkurajon konsultimet në mes të palëve të përfshira dhe institucioneve, dhe forcon pjesëmarrjen publike akoma edhe në konsultimin e vet projektit ose programit të propozuar. Përmes konsultimeve të kryera me palët e interesuara, si pjesë e procesit të VSM, është e mundur të identifikohen çështje, nevoja, shqetësime, vlera dhe ide nga ato grupe dhe pjesë të shoqërisë që mund të preken nga një politikë e veçantë, një plan ose një program (Dalal-Clayton dhe Sadler, 1999). Përveç sa më sipër, von Seht (1999) thekson përfitime edhe më konkrete nga zbatimi i VSM të cilat kanë lidhje me sa më poshtë:

- Rrit ndjeshëm promovimin e parimit parandalues në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve;
- Detyron planet dhe programet strategjike për të shqyrtuar akoma edhe më shumë zgjidhje alternative, skenarë dhe propozime;
- Rrit shanset për vlerësimin e efekteve kumulative, ndikimeve sinergjike dhe indirekte, në krahasim me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve;
- Lidh ndikimet e pritura me problemet rajonale dhe globale të mjedisit;
- Forcon transparencën dhe besueshmërinë e proceseve vendimmarrëse, pasi nxit konsultimet dhe kontribuon në ndërgjegjësimin social;
- Ofron më shumë besim tek investitorët e mundshëm dhe të kushtëzuar, kontribuon në hartimin e Studimeve më të mira të Ndikimeve në Mjedis, ndërsa njëkohësisht në



disa raste është i mundur edhe reduktimi i kohës së nevojshme për lejen mjedisore të disa projekteve dhe aktiviteteve.

2.2.3. Problemet në zbatimin e VSM

VSM përballët me një numër çështjesh teknike dhe procedurale, probleme të natyrave të ndryshme. Në lidhje me çështjet teknike, projektet e ardhshme të zhvillimit të një zone, të cilat do të rezultojnë nga zbatimi i një plani ose programi, mund të jenë të shumta dhe për këtë arsye, vlerësimi i ndikimit në mjedis krijon një kompleksitet analitik.

Informacioni mbi kushtet mjedisore aktuale dhe sidomos të ardhmen - pasi hetohet evolucioni i mjedisit të zonës sëstudimit, pa miratimin e planit ose programit të propozuar - është zakonisht i kufizuar, siç është informacioni mbi natyrën, shkallën dhe pozicionimin e saktë të projekteve të ardhshme tëpropozuara, të cilat do të rezultojnë nga zbatimi i planeve.

Përveç problemeve teknike, të rëndësishme, dhe në veçanti të vështira, paraqiten aspektet procedurale të proceseve vendimmarrëse. Politikat, planet dhe programet paraqiten përgjithësisht me një mënyrërelativisht abstrakte dhe evoluohen vazhdimisht. Për shkak të kësaj dinamike të tyre, është idomosdoshëm studimi i vazhdueshëm i ndikimeve të tyre në mjedis, gjatë gjithë rrjedhës së proceseve vendimmarrëse, fakt i cili e bën Strategjinë e Studimit të Ndikimeve në Mjedis akomaedhe më të vështirë. Përveç kësaj, nuk ka kufijë të qartë për ndarjen e politikave të ndryshme,planeve dhe programeve, domethënë, nuk mund të ketë ndarje të plotë të objekteve midis treplaneve, një për transport, një për energjinë dhe një për përdorimin e tokës, pasi ekzistojnëmarrëdhënie të ndikimit të ndërsjelltë në mes tyre.

Gjithashtu, vihet re se efektet e një politikevaren në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mënyra me të cilën u dha interpretimi në politikë, meqëllim zbatimin e saj, realizimin e saj. Në fund të fundit vendimi është një politikë procesi, faktqë do të thotë se palët e vendimmarrjes nuk do të marrin parasysh vetëm efektet mjedisore ngazbatimi i një politike, i një plani apo një programi, por do të përlllogarisin dhe vet interesat e tyre,si edhe ndikimet në nivel politike (Glasson et al., 2012). Përveç çështjeve të mësipërme, Noble(2003) argumenton se është veçanërisht e vështirë për tu studiuar efektiviteti i një VSM, pasi ai,në një masë të madhe, varet jo vetëm nga efektet e



tij dhe nga mënyra se si ai ndikon vendimmarrjen me mbrojtjen e mjedisit, por edhe nga cilësia e procesit të përgjithshëm, siç përcaktohet nga proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimet. Akoma edhe sistemet e ndryshme dhe kuadri institucional i VSM në çdo vend, formësojnë kritere të ndryshme për vlerësimin e efektivitetit të tij, të cilat përcaktohen nga direktivat përkatëse dhe kuadri ligjor (Noble, 2003). Si rrjedhim krahasimi midis VSM të ndryshme të vendeve të ndryshme nuk është menjëherë i mundshëm dhe kjo krijon ngatërresë/komplikim në shkëmbimin e pikëpamjeve dhe përvojave, në mënyrë që të realizohet zhvillimi i tyre shkencor.

3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

3.1. Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlament i Evropian, 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative.

3.2. Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke ushqyrtuar çështjet mjedisore dhe të.

Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.



3.3. Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor me që bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune.

Prioritetet e strategjisë janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nismat e tjera si Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë përshkathtësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë dotë mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme sipër shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjëra tepër të rritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

3.4. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB kan një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t’isigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në



Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit 2. Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programete vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2020 të arrihet një përmirësim irëndësishëm në jetë të shtëpisë për 100 banorë të lagjeve të varfra.

3.5. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

Konventa Århus Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit “Mjedisi për Evropën”. Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001. Konventa Århus vendosë një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasje ,1998).

3.6. Konventa ESPOO dhe Protokolli i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi Mjedisor, 1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka

gjasa të kenën dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve.

Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008).

3.7. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet;
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

3.8. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)

Ligji Nr. 03/L-230 nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të Planeve dhe të Programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis.

Lista e Planeve dhe e Programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Këto Plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM.

4. GJENDJES EKZISTUESE – ANALIZA

4.1. Pasqyra e përgjithshme

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike sepse gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Ferizaj, Gjilan dhe Artanë.



Ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor – hekurudhor e përmes Vrellës edhe atij ajror, për shkak se Aeroporti i vetëm ndërkombëtar gjendet në territorin e Komunës së Lipjanit dhe është nga qendra vetëm 15 km. Në anën perëndimore shtrihet rezervati Blinaja që do të mund të zhvillohej në një qendër rekreative dhe atraktive për tërë rajonin. Në vendbanimin Gadime gjendet Shpella e Mermerit që paraqet një atraksion të rëndësishëm turistik jo vetëm për Komunën e Lipjanit por për tërë Kosovën. Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër Janjeva po ashtu konsiderohet si vend atraktiv për vizitorë.


Komuna e Lipjanit ka 62 fshatra, ku numri më i madh i tyre janë të koncentruar në fushëgropën e Kosovës që paraqet pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit, ndërsa vendbanimet tjera shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjik-pjesëve kodrinore malore të komunës së Lipjanit.

Një pjesë e madhe e popullsisë, industria dhe institucionet qendrore janë të vendosura në rrafshin e Kosovës në regjionin përreth kryeqytetit Prishtina, duke përfshirë komunën e Lipjanit, Kastriotit dhe Fushë Kosovës. Prishtina është kryeqytet dhe qendër administrative, edukative dhe kulturore e Kosovës me një universitet të vetëm (publik), teatër kombëtar dhe klinikë universitare.

Lipjani është një nyje transporti me të vetmin Aeroport ndërkombëtar në Kosovë dhe të gjitha linjat e rrugëve hekurudhore dhe nacionale që përshkon zonën. Autostrada e planifikuar Prishtinë-Hani i Elezit-Shkup kalon nëpër territorin e Komunës, e cila i mundëson qasje Lipjanit në Autostradë.



Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Lipjanit



4.2. Struktura topografike

Në bazë të konsultimit të hartave topografike dhe kadastrale, është vlerësuar se shumica e këtyre vendbanimeve kanë pozitë të përshtatshme në raport me zonat e tyre kadastrale dhe janë të lidhura mjaft mirë mes veti si dhe me qendrat tjera të rendit më të lartë.

Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë vijës së asfaltuar të vendbanimit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodh kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi me rrugën kryesore. Ky proces mund të quhet transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë.

Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i aglomerimit ose bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Janjeva, Gadima e., Ribari i Madh, Sllavia, Toploqani, për shkak të zgjerimit dhe formës aglomerative në hapësirë këto vendbanime në të ardhmen nuk mund ta ruajnë kuptimin e fshatit.

4.3. Malet dhe fushat

Zona malore e komunës shquhet me potencial të madh të turizmit të bazuar në natyrë, si Rezervati Blinaja, bukuritë e peizazheve Shalë-Kleqkë dhe vargmalet e Zhegovcit. Terrenet kodrinore-malore, kryesisht i ekspozohen rrëshqitjeve si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Gërryerjet për qëllime zgjerimi dhe asfaltimi të rrugëve, trualleve, kanë shkaktuar rrëshqitje në disa vende, ku mbizotëron terreni kodrinor-malor, në mungesë të strukturave mbrojtëse.

Fshatrat kodrinore malore: Bukovicë, Gllavicë, Hanroc, Lipovicë, Okosnicë, Plitkoviq, Sedllar, Shishare, Zllakuqan.

4.4. Rrafshinat

Nga të dhënat e përgjithshme të Komunës me theks relievit të territorit të komunës së Lipjanit sipas të cilave pjesa më e madhe e sipërfaqeve janë rrafshina me 44.53 %, nga ana jugperëndimore 10.98 %, të lindjes 4.03 %, pjesa veriore si më negative është kryesisht në terrenet e larta rreth 5.78 %, verilindore 7.96% dhe veriperëndimore 6.71%. Në kuadër sipërfaqeve të rrafshëta gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre.

4.5. Pjerrtësia

Nga të dhënat e përgjithshme të Komunës me theks relievit të territorit të komunës së Lipjanit sipas



të cilave pjesa më e madhe e sipërfaqeve janë rrafshina me 44.53 %, nga ana jugperëndimore 10.98 %, të lindjes 4.03 % , pjesa veriore si më negative është kryesisht në terrenet e larta rreth 5.78 %, verilindore 7.96% dhe veriperëndimore 6.71%.

4.6. Lumenjtë dhe sipërfaqet tjera ujore

Në aspektin hidrografik ujërat në Komunën e Lipjanit i takojnë pellgut të Detit të Zi, ndërsa lumenjtë më të mëdhenj janë lum i Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Në përgjithësi rrjeti hidrografik është i pasur dhe me potencial ujorë të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumëvjeçare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madh në komunë e Lipjanit i cili degët më të zhvilluara i ka në anën lindore, ndërsa degët kryesore hidrografike të anës lindore janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi i Sazlisë ndërsa, në anën perëndimore lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit. Sasitë më të mëdha të të reshurave janë gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet dhe kur kemi edhe paraqitjen e kënetave, posaçërisht në tokat të cilat nuk e lëshojnë ujin në lidhje me ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit. Këto hulumtime janë ende në vazhdim dhe janë në pritje të finalizimit të projektit dhe fillimin e punimeve.

4.7. Struktura gjeologjike

Morfologjia Duke qenë se të dhënat për rezervat e të gjitha llojeve të resurseve minerale janë të viteve të më hershme, duhet të merren me një rezervë të caktuar, mirëpo prapëseprapë duhet vënë në dukje se në territorin e Komunës së Lipjanit ka resurse dhe rezerva të lëndëvetë para minerale qofshin ato energjetike, metalore dhe jometalore të cilat janë premtuese për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Mirëpo nga ana tjetër, këtë e vënë në dukje problemi i gjendjes jo të mirë të minierave ekzistuese, si dhe problemet lidhur me rezervat e disa lëndëve minerale dhe mundësitë e eksploatimit të tyre për një periudhë më afatgjatë. Kjo parashtrohet nevojën urgjenteqëtë bëhen programe dhe këto programe të vihen në



prioritet të Komunës së Lipjanit që përmes financimit të projekteve për kërkimin-hulumtimin dhe eksplotimin e këtyre resurseve minerale të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Vendburimet e qymyrit në komunën e Lipjanit - Vendburimet e qymyrit ndodhe në vendbanimin Babush. Eksplotimi i qymyrit në Minierën e Babushit ishte bërë gjatë viteve të 80-ta. Po ashtu rezerva të konsiderueshme të qymyreve në komunën e Lipjanit janë vazhdimësi e basenit qymyror të Kosovës.

Xeheroret e hekurit – nikelit silikat - Shfaqjet e xeherorëve të Fe – Ni silikat në komunën e Lipjanit janë zbuluar për herë të parë në vitin 1958 në Kodrën e quajtur Gllavicë, e cila ndodhet ndërmjet vendbanimeve Magurë dhe Medvecë. Punimet gjeologjike në atë kohë ishin kryer nga Enti për Kërkime - Hulumtime Gjeologjike. Eksplotimi më intensiv i xeherorit silikat të Fe-Ni në vendburimin e Gllavicës ishte nga viti 1985 e deri në vitin 1990. Në vitin 1997 e deri 2005, kjo minierë pushoi aktivitetin e saj. Në vitin 2005, vendburimi Fe- Ni “Gllavica” u privatizua dhe pas fazës së përgatitjeve dhe rivitalizimit të infrastrukturës filloi eksplotimi i kësaj xehe. Vendburimi Gllavica përfshin sipërfaqe prej 1.008.000 m², por nuk kufizohet vetëm brenda këtij kufiri.

Xeheroret e Kromit - Në masivin ultramafike të Goleshit janë zbuluar disa shfaqje mineralizuese të xeherorit të Kromit, por hulumtimet detale mbi mineralizimet e këtij lloji mungojnë.

Ndonëse, i gjithë masivi i Goleshit është i mbuluar në një masë të madhe me punimet hulumtuese të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara për hulumtime të xeherorit silikat të Nikelit dhe Magnezitit dhe jo për kërkimin e mineralizimeve të Kromit.

Vendburimi i dunitëve - Në territorin e komunës së Lipjanit në pjesën Jug – Lindore të shpateve të masivit ultramafik të Goleshit, në afërsi të vendbanimit Medvec gjendet vendburimi Dunitëve. I pari i cili veçoi dunitet ishte gjeologu T. Emil në vitin 1960, i cili punonte në Minierën e magnezitit në Golesh.

Ky vendburim ndodhet në largësi rreth 14 km nga qendra komunale Lipjani. Hulumtimet e para janë realizuar nga një grup gjeologësh të Entit për Gjeologji



dhe Hulumtime Gjeofizike nga Beogradi gjatë vitit 1958, të cilët kanë kryer rlevime gjeologjike të rajonit për hartën themelore gjeologjike, e cila ka përfshirë masivin ultramafik të masivit të Goleshit dhe rajonit të gjerë.

Ky vendburim ndodhet në largësi rreth 14 km nga qendra komunale Lipjani. Hulumtimet e para janë realizuar nga një grup gjeologësh të Entit për Gjeologji dhe Hulumtime Gjeofizike gjatë vitit 1958, të cilët kanë kryer rlevime gjeologjike të rajonit për hartën themelore gjeologjike, e cila ka përfshirë masivin ultramafik të masivit të Goleshit dhe rajonit të gjerë.




Figura 2. Karakteristikat Gjeologjike

4.8. Burimet minerale

Duke qenë se të dhënat për rezervat e të gjitha llojeve të resurseve minerale janë të viteve të më hershme, duhet të merren me një rezervë të caktuar, mirëpo prapëseprapë duhet vënë në dukje se në territorin e Komunës së Lipjanit ka resurse dhe rezerva të lëndëvetë para minerale qofshin ato energjetike, metalore dhe jometalore të cilat janë premtuese për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Mirëpo nga ana tjetër, këtë e vënë në dukje problemi i gjendjes jo të mirë të



minierave ekzistuese, si dhe problemet lidhur me rezervat e disa lëndëve minerale dhe mundësit e eksploatimit të tyre për një periudhë më afatgjatë.

Kjo parashtrohet nevojën urgjente që të bëhen programe dhe këto programe të vihen në prioritet të Komunës së Lipjanit që përmes financimit të projekteve për kërkimin-hulumtimin dhe eksploatimin e këtyre resurseve minerale të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Vendburimet e qymyrit në komunën e Lipjanit - Vendburimet e qymyrit ndodhe në vendbanimin Babush. Eksploatimi i qymyrit në Minierën e Babushit ishte bërë gjatë viteve të 80-ta. Po ashtu rezerva të konsiderueshme të qymyreve në komunën e Lipjanit janë vazhdimësi e basenit qymyror të Kosovës.

Xeheroret e hekurit – nikelit silikat - Shfaqjet e xeherorëve të Fe – Ni silikat në komunën e Lipjanit janë zbuluar për herë të parë në vitin 1958 në Kodrën e quajtur Gllavicë, e cila ndodhet ndërmjet vendbanimeve Magurë dhe Medvecë. Punimet gjeologjike në atë kohë ishin kryer nga Enti për Kërkime - Hulumtime Gjeologjike. Eksploatimi më intensiv i xeherorit silikat të Fe-Ni në vendburimin e Gllavicës ishte nga viti 1985 e deri në vitin 1990. Në vitin 1997 e deri 2005, kjo minierë pushoi aktivitetin e saj. Në vitin 2005, vendburimi Fe-Ni “Gllavica” u privatizua dhe pas fazës së përgatitjeve dhe rivitalizimit të infrastrukturës filloi eksploatimi i kësaj xehe. Vendburimi Gllavica përfshin sipërfaqe prej 1.008.000 m², por nuk kufizohet vetëm brenda këtij kufiri.

Xeheroret e Kromit - Në masivin ultramafike të Goleshit janë zbuluar disa shfaqje mineralizuese të xeherorit të Kromit, por hulumtimet detale mbi mineralizimet e këtij lloji mungojnë.

Ndonëse, i gjithë masivi i Goleshit është i mbuluar në një masë të madhe me punimet hulumtuese të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara për hulumtime të xeherorit silikat të Nikelit dhe Magnezitit dhe jo për kërkimin e mineralizimeve të Kromit.

Vendburimi i dunitëve - Në territorin e komunës së Lipjanit në pjesën Jug – Lindore të shpateve të masivit ultramafik të Goleshit, në afërsi të vendbanimit Medvec gjendet vendburimi Dunitëve. I pari i cili veçoi dunitet ishte gjeologu T. Emil në vitin 1960, i cili



punonte në Minierën e magnezitit në Golesh. Ky vendburim ndodhet në largësi rreth 14 km nga qendra komunale e Lipjanit.

Hulumtimet e para janë realizuar nga një grup gjeologësh të Entit për Gjeologji dhe Hulumtime Gjeofizike nga Beogradi gjatë vitit 1958, të cilët kanë kryer rilevime gjeologjike të rajonit për hartën themelore gjeologjike, e cila ka përfshirë masivin ultramafik të masivit të Goleshit dhe rajonit të gjerë.

Ky vendburim ndodhet në largësi rreth 14 km nga qendra komunale Lipjani. Hulumtimet e para janë realizuar nga një grup gjeologësh të Entit për Gjeologji dhe Hulumtime Gjeofizike gjatë vitit 1958, të cilët kanë kryer rilevime gjeologjike të rajonit për hartën themelore gjeologjike, e cila ka përfshirë masivin ultramafik të masivit të Goleshit dhe rajonit të gjerë.

Tabela 1. Rezervat e mineraleve

Përbërësit	Standardi botëror	Kërkesat industriale	Përmbajtja mes dunitëve në Medvec
MgO	Min. 37.00	Min. 40.00	44.30
Al ₂ O ₃	Max. 2.30	Max. 1.50	0.53
CaO	Max. 1.50	Max. 1.25	0.58
MgOFeO	Min. 3.50	Min. 4.00	4.75
MgOSiO ₂	0.94-1.33	1.00	1.06
Humb. nga ferg (H.F)	3.00	2.00	200

4.9. Kushtet klimatike

Sipas të dhënave të IHMK. Temperatura mesatare vjetore në rajonin e ngushtë është 10 gradë celsius, kurse që në viset malore zbresin në 9 gradë celsius. Muajt më të nxehtë janë korriku dhe gushti me temperaturë mesatare 20,60 dhe 20, 50 gradë celsius, ndërsa më i ftohti është janari me –1,4 gradë celsius. Maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është në gusht 37, 30 gradë celsius, ndërsa minimumi – 26, 0 gradë celsius.

Të reshurat - Sasitë e të reshurave në këto rajone janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë. Sasitë mesatare vjetore sillen rreth 595.40 mm në rajonin e Ferizajt, sipas të dhënave të IHMK.



Tabela 2. Shuma mesatare mujore dhe vjetore të shkëlqimit diellorë në orë

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t(h)	68	93	141	171	218	232	280	274	221	171	92	57	2018

Pozita e lipjanit është epershtashme dhe ka shkëlqim diellorë sipas të dhënave të IHMK mujet me shkëlqim djellore janë Prill deri në Tetorë ndërsa shuma mesatare vjetore është 2018 t (h) .(shih tabel 2.)

Lagështia relative e ajrit - Ka vlerë mesatare vjetore 74,70 % më muajin gusht më të thatë (63%) dhe me muajin më lagështi më të madhe janarin (86,1%). Sipas të dhënave të IHMK.

Era - Frekuencën më të madhe vjetore në rajonin e Ferizajt kanë erërat verilindore (NE) me 226 0/00 ndërsa më të voglën ato lindore (E) me gjithsej 36 0/00. Shpejtësia mesatare është më e madhja të era juglindor (SE) 4, 0m/s, sipas të dhënave të IHMK.

4.10. Vlerat natyrore

Në Komuna e Lipjanit është e pasur me resurse natyrore, të cilat paraqesin bazë të volitshme për zhvillim. Më të rëndësishme janë burikiet që më së shumti gjenden në pjesët perëndimore dhe lindore të komunës, ndërsa pjesa qendrore është e pasur mëthëngjill. Mineralet më të rëndësishme që i posedon komuna janë magneziti, nikeli, thëngjilli, zinku, kromi, duniti, rëra, kuarci, zhavorri. Faktorët natyror si pozita gjeografike, morfologjia e terrenit, kushtet klimatike dhe karakteristikat hidrografike kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e deritanishëm të komunës.

4.11. Mënyra e shfrytëzimit të tokës

Prej rreth 338.40 km² sa ka komuna e Lipjanit, vlerësohet se pothuajse gjysma e kësaj sipërfaqeje është tokë Bujqësore apo më saktësisht 45.22%. Sipërfaqe tjetër më e madhe është ajo e Tokës Pyjore e cila në komunën e Lipjanit ndahet në dy lloje të shfrytëzimeve ekzistuese, si tokë pyjore, zona të mbrojtura (Rezervati i Gjuetisë Blinaja) dhe Zona të veçanta (Kleçkë dhe Divjakë), ku së bashku këto zona formojnë një sipërfaqe pyjore prej 14913.06 ha apo 44.06% të gjithë territorit të komunës së Lipjanit. Në vazhdim janë të paraqitura të gjitha shfrytëzimet ekzistuese të territorit të komunës së Lipjanit në sipërfaqe për hektar si dhe në përqindje.



4.12. Erozioni

Erozioni, dukuri që më së shumti prek terrenet e pjerrëta dhe me strukturë të shkruftë të tokës (kryesisht ato me material ranor- kokrrizor), si dukuri po shënon rritje në forma dhe madhësi të ndryshme për shkak të ndikimit të disa faktorëve, shpyllëzimet, zjarret, degradimi i vegjetacionit, etj, kryesisht paraqitet në formë të zhveshjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, përgjatëbrigjeve të shtretërve të lumenjve e përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mungesës së strukturave mbrojtëse, etj.

Zjarret, të cilat përfshijnë drunjë e shkurre, planifikimi jo adekuat i kanaleve kulluese së bashku me faktorët klimatik kur kombinohen, rrisin ekspozimin ndaj këtij efekti. Reshjet intensive, në mungesë të mbulesës bimore, çojnë në zhveshjen e terreneve dhe gërryerjen e sasive të mëdha të dheut dhe gurëve. Në shumicën e rasteve materiali i bartur përfundon në lumenj duke devijuar rrjedhën dhe duke shkaktuar vërshime. Përveç degradimit të terrenit dhe kostove të konsiderueshme për pastrim dhe mirëmbajtje të burimeve ujore, ky fenomen po shkakton efektet më të mëdha në rrjedhën e epërme të lumenjve dhe përroskave.

4.13. Trashëgimia natyrore

Ruajtja e trashëgimisë natyrore është shumë e rëndësishme fillimisht për biodiversitetin e zonës, si habitate kritike për botën bimore dhe shtazore, luajnë një rol jetik në rregullimin e klimës përmes proceseve si sekuestrimi i karbonit dhe menaxhimi i ujit, si dhe mundësi për turizëm dhe rekreacion të kontrolluar. Me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë natyrore, MMPHI konkretisht AMMK ka hartuar listën për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, në bazë të së cilës në komunën e Lipjanit janë nën mbrojtje 1 asete të kategorizuara si Zonë e Veçantë e Mbrojtur dhe 1 asete të kategorizuara si Peizazhe të Mbrojtura:

- Zonë e veçantë e mbrojtur e zogjve (Ligatina e Hencit-Radevës);
- Vendgjueti me Rëndësi të Veçantë – Blinaja (Peizazh i Mbrojtur);
- Shpella e Gadimes (Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik).



Ndërsa në nivel lokal, Komuna ka nën mbrojtje edhe disa asete të trashëgimisë natyrore të cilat kanë vlerë në zinxhirin natyror të komunës, këto asete janë të listuara si më poshtë:

- Lokaliteti i Boshtrës “Forsythia Europaea” (Monument natyror me karakter botanik);
- Burimet e Ujit në Baicë (Monument Natyror me karakter hidrologjik);
- 7 asete të tjera në kategorinë Monument Natyror me karakter botanik;
- 1 aset Monument Natyror me karakter gjeomorfologjik.

4.14. Transporti dhe infrastruktura

Transporti është një ndër komponentët kyç për përmbushjen e kërkesave për lëvizje ditore. Është faktor përmbajtësor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor, si dhe luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore ndërmjet hapësirave dhe destinimeve të tyre.

Infrastruktura e transportit duhet të përballojnë kërkesat e vazhdueshme për sa i përket kërkesës për transport, tendencave të reja, presioneve shoqërore dhe efikasitetit të buxhetit.

Lipjani është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme nacionale dhe evropiane N 25 (E 752) dhe N2 (E 65), ndërsa hekurudha kryesore Mitrovicë/Fushë Kosovë dhe Ferizaj/Shkup e cila kalon në mes të Lipjanit me stacionin e pasagjerëve dhe trafikut të mallrave, e lidhë Kosovën me korridorin e X hekurudhor panevropian.

Ky pozicion gjeografik i ofron Komunës së Lipjanit mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor-hekurudhor dhe ajror, për shkak se Aeroporti i vetëm ndërkombëtar ndodhet në Komunën e Lipjanit dhe është nga qendra vetëm 15 km.

Komuna e Lipjanit karakterizohet me tri lloje të transportit atë rrugor, hekurudhor dhe atë ajror. Infrastruktura e transportit në komunën e Lipjanit shtrihet në një gjatësi prej 433.3 km, e cila gjatësi përbëhet nga infrastruktura rrugore me gjatësi prej 412 km (ose 95%), infrastruktura hekurudhore me një gjatësi prej 8.9 km (ose 2%) dhe infrastruktura ajrore me një gjatësi prej 11.4 km (ose 3%).



Në komunë e Lipjanit për nga karakteri ekzistojnë katër nivele të rrugëve, duke filluar nga autoudha, rrugët nacionale, rajonale dhe ato lokale.

Në përputhje me Ligjin, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për menaxhim, ndërtim, rindërtim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rrugëve rajonale. Ndërsa, Komuna e Lipjanit është përgjegjëse për rrjetin rrugor lokal.




Figura 3. Infrastruktura rrugore

4.15. Ujësjetësi

Furnizimi me ujë për qytetarët e komunës së Lipjanit bëhet nga burimet nëntokësore, i cili ka kapacitet prej 399.00 l/s, përfshirë edhe zonat rurale të cilat furnizohen nga pusët po ashtu nëntokësore.



Aktualisht KRU „Prishtina” sh.a, e cila është ofruesi i vetëm me ujë të pijshëm në zonën e Lipjanit, ofron shërbime të ujit të pijshëm për qytetin e Lipjanit dhe disa vendbanime, ky shërbim ofrohet 24 orë pa ndërprerje, me përjashtim të rasteve kur ka defekte apo probleme tjera (reduktime të energjisë) në stacionin e pompave dhe tubacionet – rrjetin shpërndarës të ujësjellësit. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU Prishtina është rreth: 277500.0 m’ apo 277.50 km përfshirë edhe zonat rurale, të regjistruara në ArcMAP.

Diametri i gypave primar sillet nga Ø315mm Ø50mm për gypa primare dhe sekondare, kurse për gypat terciar për kyçje kolektive dhe individuale sillen nga Ø40mm deri Ø25mm si dhe materialet e tyre janë nga Asbest Cement (AC), PVC, GIZË, HDPE dhe kohëve të fundit PE-100-RC.

4.16. Kanalizimi

Shërbimi aktual ofron shërbime të kanalizimit rreth 60% të popullsisë (zona e përgjithshme e furnizimit).

Ujërat e ndotura nga qyteti i Lipjanit rrjedhin pa u trajtuar në rrjedhat ujore përreth. Në qytetin e Lipjanit shkalla e kyçjes në sistemin e kanalizimeve është në masën 85%.

Gjatësia totale e sistemit ekzistues të kanalizimeve në Lipjan është rreth 160km përfshirë edhe zonat rurale. Diametrat e gypave janë midis DN 200 dhe DN 600, dhe materiali kryesor i gypave është azbest çimentoja (> 80 %, kryesisht diametrat më të vegjël). Material tjetër i gypave është PE dhe gypat e plastikës. Vlen të theksohet se përafërsisht 80% e banorëve që jetojnë në qytet, ujërat fekale i derdhin në rrjetin ekanalizimit fekal publik. Gjendja ekanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet sendodhin rrjedhje të mëdha.




Figura 4. Shtrirja e rrjetit të kanalizimit

4.17. Trajtimi i ujërave të ndotura

Implantin për trajtimin e ujërave të ndotura në (Medvec-Vrellë)- Lipjan, gypi prurës në Implant është D=400 mm. Implanti për trajtimin e ujërave të ndotura në Vrellë është implant me trajtim biologjik që përbëhet nga tre SBR reaktor (Sequencing Batch Reactors). Procesi i trajtimit kontrollonhet përmes sistemit SCADA, uji i trajtuar me gravitet shkarkohet në receptor. Implanti tani është në menaxhim nga fillimi i muajit nëntor 2021, Kapaciteti i Implantit është 3047 PE (banor ekuivalent).

Maksimumi ditore i ujërave të ndotur: $Q_d = 1950 \text{ m}^3/\text{dite} = 22,4 \text{ l/s}$.

Mesatarja ditore i ujërave të ndotur: $Q_{24} = 750 \text{ m}^3/\text{dite} = 12,7 \text{ l/s}$

Shkarkimi i ujërave të zeza në të gjithë territorin përbën një tjetër burim kryesor të



ndotjes së ujërave, ku 51 (83.60%) e vendbanimeve llogaritet të jenë të kyçur në rrjetin e kanalizimit. Rrjeti i kanalizimit i ndërtuar në periudhën e pas luftës në disa fshatra, bëjnë shkarkimin e ujërave fekale në ambient të hapur duke iu nënshtuar trajtimit përmes gropave septike

Vlerësim i përgjithshëm i mbulueshmërisë së vendbanimeve të kyçur në rrjetin e kanalizimit është përafërsisht:

- 34.50% të vendbanimeve, me popullsi mbi 1,000 banorë, janë të kyçur 100% në sistemin e kanalizimit, me përjashtim të vendbanimeve Janjevë (75%), Krojmir (75%), dhe Lipjan (80%);
- 49.20% të vendbanimeve, të cilat kanë më pak se 1,000 banorë, janë të kyçur 100% në sistemin e kanalizimit, me përjashtim të vendbanimeve Akllap (80%), Gllavicë (85%), Mirenë (75%), Resinoc (90%), dhe Varigoc (80%);
- 33 nga 51 vendbanime bëjnë shkarkimin e ujërave të trajtuar paraprakisht përmes gropave septike;
- Gjithsej 6 vendbanime janë të pabanueshme: Bukovicë, Divlakë, Hanroc, Okosnicë, Shisharkë, Vogaqicë;
- Parku Nacional Blinaja menaxhohet dhe shërbehet nga operator tjetër i kontraktuar nga niveli qendror;

Rreth 6.5% apo në total 4 vendbanime nuk janë të kyçur në sistemin e kanalizimit: Brus, Kleqkë, Plitkoviq, Vrellë e Gadimes.

Objektet e banimit që nuk janë të kyçura në sistemin e kanalizimit i derdhin ujërat e zeza në lumenjtë më të afërt apo përroska të vogla, shfrytëzojnë gropa septike ose lejojnë që ujërat e zeza të derdhen në dhe’.

Stacionet e trajtimit të ujit në përputhshmëri me standardet e Evropës Perëndimore nuk ekzistojnë ende, megjithatë planifikohet të ndërtohen qendra për trajtimin e ujit në qytetin e Lipjanit dhe pjesët tjera të komunës.



4.18. Menaxhimi i mbeturinave

Aktualisht shërbimi i menaxhimit, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunën e Lipjanit ofrohet nga KRM “Pastrimi”: NJ.O. Lipjan. KRM “Pastrimi” është ndërmarrje publike në cilësinë e shoqërisë aksionare, e licencuar në bartjen e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike.

Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset dhe konsumatorët publik. Kompania ofron shërbimin e grumbullimit dhe bartjes së mbeturinave si veprimtari primare, dhe mirëmbajtjen e rrugëve (fshirjen, larjen dhe largimin e bores) apo veprimtari tjera shërbyese, si veprimtari dytësore, me kontrata të veçanta me komunën.

Të dhënat nga operatori tregojnë se rrjeti i shërbimit është i shtrirë në rreth 90% të territorit të komunës. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në zonën urbane, peri-urbane dhe atë rurale.

Klientët e amvisërisë ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, pjesa më e madhe e pranojnë shërbimin derë më derë (grumbullimi kryhet çdo ditë të javës) dhe klientë të pajisur me kontejnerë (grumbullimi kryhet 1 herë në javë). Në zonat peri-urbane dhe rurale, klientët e amvisërisë e pranojnë shërbimin derë më derë, me frekuencë grumbullimi po ashtu 1 herë në javë.

Sa i përket infrastrukturës grumbulluese, bartëse dhe transportuese të kompanisë përbëhet nga kamionë kompaktorë, rrotullues dhe vetëngarkues përmes të cilëve bëhet grumbullimi i mbeturinave dhe bartja e tyre deri tek stacioni i transferit. Kompania zotëron me 7 kamionë kompaktorë kapaciteti bartës i të cilëve nuk dihet, 1 kamion kompaktorë me kapacitet 7 ton dhe një tjetër me kapacitet 14 ton. 2 kamionë vetëngarkues si dhe një rimorkio i cili përdoret për transferimin e mbeturinave për në deponinë sanitare.

Komuna e Lipjanit është në përfundim të hartimit të Planin Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh, sipas Ligjit për Mbeturina.

Për kategoritë tjera të mbeturinave si bateritë, vajrat mbeturinë (rrjedhjet eventuale), mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, nuk ka ndonjë të dhënë se si



qëndron gjendja e tyre.

Në përgjithësi, ndarja e mbeturinave, trajtimi dhe deponimi pasqyrohen të pafavorshme, si pasojë e mungesës së infrastrukturës, zbatimit të nismave dhe shkaqe vetëdijesimi.

Një gjenerim mesatar i mbeturinave në nivel komune për kokë banori është siguruar nga baza e të dhënave nga operatori K.R.M “Pastrimi”, dhe planet komunale. Operatori përcakton sasinë përmes peshimit të mbeturinave të përziera komunale, nga ku rezulton 13,033 ton/vit mbeturina të gjeneruara në komunën e Lipjanit, 56,673 banorë të shërbyer, gjenerimi për kokë banori rezulton 229.9 kg/banorë/vit. Shifra mbi gjenerimin e mbetjeve për vit është marrë për të tre kategoritë e klientëve, duke qenë se operatori nuk aplikon gjenerimin ndaras sipas kategorive.

4.19. Furnizimi me Energji Elektrike

Në Komunën e Lipjanit janë të lokalizuara një nr. i konsiderueshëm i transformatorëve të tensioneve të ndryshme të cilat mundësojnë furnizimin me energji elektrike të komunës së Lipjanit në mënyrë stabile.

Transformatorët sipas kategorisë:

- TS 35/10 kV – 2;
- TS 10 (20) kV – 1;
- TS 10/0.4 kV – 391.

4.20. Trashëgimia kulturore

Territori i Komunës së Lipjanit është mjedis jetësor historik që karakterizohet me trashëgimi të pasur kulturore material dhe jomateriale të krijuar në harkun kohorë në kontinuitet nga parahistoria dhe deri sot. Kjo trashëgimi kulturore është pjesë integrale e peizazhit në të gjitha vendbanimet urbane dhe rurale dhe, formëson një mozaik të pasur të kulturës tradicionale të praktikuar ndër breza e mileniume.

Me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore të RKS, MKRS (Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit) me Vendim nr. 149/2022, dt. 07.10.2022, në Lista e Trashëgimisë Kulturore të RKS, nga sfondi trashëgimisë kulturore të Komunës së Lipjanit vendosi në

mbrojtje 35 asete, duke përfshirë kategoritë:

- Trashëgimi arkitekturore, 12 asete;
- Trashëgimi arkeologjike, 13 asete;
- Trashëgimi të luajshmë, 1 asete;
- Trashëgimi shpirtërore asete;
- Zonë e veçantë të mbrojtura, 2 aset ;




Figura 6. Trashëgimia kulturore

4.21. Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Zonat Veçanta të Mbrojtura shtrihen në një të sipërfaqe të përgjithshme prej 0.56 ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me shfrytëzim për veprimtari komerciale.

Tabela 4. Zonat Veçanta të Mbrojtura sipas sipërfaqeve (ha) të shtrirjes në zona kadastrale.

Baicë	Divjakë	Kleçkë	Shalë
257.86	204.95	420.04	91.94

Tabela 5. Zonat e veçanta të mbrojtura

Njësia kadastrale, Emri	Statusi ligjor	Sipërfaqja (ha)
	Statuti ligjor	
Kisha e Shpalljes së Virgjërshës, Lipjan	I mbrojtur	0.65

Tabela 6.. E Zonë e veçantë e mbrojtur e Zogjve(109.5 / ha)

Kodi	Emertimi	Komuna/zona	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja ari	Kategoria sipas IUCN	Viti i mbrojtjes	Pershkrimi i shkurter
ZVM_001	Zonë e veçantë e mbrojtur e Zogjve	F. Kosove Graçanic, Lipjan	109	5	V	2014	vlerave dhe karakteristikave të veçanta natyrore si: ornitologjike, htiologjike, hidrogeologjike,botanike dhe peisazhore

4.22. Profili demografik

Zhvillimi demografik është një fushë mjaft komplekse dhe me rëndësi të veçantë për planifikim dhe zhvillimin e përgjithshëm për të ardhmen e një vendi. Në përgjithësi, i tërë planifikimi, për një zhvillim të qëndrueshëm, bëhet për krijimin e kushteve më të mira të jetesës së njerëzve, në vendin ku ata jetojnë. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës, duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime në të ardhshme. Bazuar në rrjedhën e zhvillimit të komponentëve të zhvillimit demografik më realisht mund të planifikohen kërkesat dhe nevojat e shoqërisë për të tashmen dhe



të ardhme. Ndërsa, sipas vlerësimit të ASK-së, në vitin 2011 Kosova ka shënuar rritje të popullsisë në 1,795,666 banor. Ndërsa, Komuna e Lipjanit sipas regjistrimit të vitit 2011 (ASK), kishte 57,605 banor.

Komuna e Lipjanit numëron 57605 banorë, për vitin 2011, ka rritje të numrit të përgjithshëm të popullsisë sipas vlerësimi të ASK- se, në vitit 2021, kemi 58,601 banor. Përgjatë një dekade dallohet si Kosova ashtu sikundër edhe Komuna e Lipjanit kanë pasur rritje të popullsisë krahasuar me ritmet në vitet e kaluara. Kjo situatë na bënë të kuptojmë se kemi të bëjmë me rritjen apo stagnim të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune.

Shërbimet arsimore

Sipas të dhënave të komunes, Komunë të Lipjanit ka 3 institucione arsimore parashkollore me gjithsejtë: 304 fëmijë të regjistruar; dhe 26 edukator të punësuar.

Në Komunë të Lipjanit ka 26 institucione arsimore fillor dhe të mesëm të ultë dhe 17 paralele të ndara me gjithsejtë:

- 5,740 nxënës të regjistruar; dhe
- 655 mësimdhënës.

4.23. Struktura ekonomike

Konsiderohet se shkalla e papunësisë në komunë e Lipjanit është e lartë. Kjo tregon edhe për gjendjen e mirëqenies njerëzore në këtë komunë duke shprehur rëndimin më negativ që ka komuna e Lipjanit. Gjithashtu edhe të ardhurat për kokë banori janë të vogla për shkak të shkallës së lartë të papunësisë, pagave të vogla si dhe familjet me shumë anëtarë kushtëzojnë të ardhura të vogla në Komunën e Lipjanit.

Ne Komunën e Lipjanit figurojnë të regjistruar 2661 ndërmarrje të regjistruara. Ekonomia e Komunës së Lipjanit kryesisht bazohet në biznese të vogla tregtare, ndertimi, industria perpunuse etj. Ne tabelen me poshte jane te peraqitura një numër i konsiderueshëm i bizneseve të cilat operojnë në veprimtari të ndryshme, por që dominon sektori i tregtisë me



Komuna e Lipjanit
Rejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit

KOMUNA E LIPJANIT

30% si biznese mikro dhe të vogla. Sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë kanë pjesëmarrjen më të vogël, me nga 1%.

Tabela 6. Sektorët ekonomik dhe struktura e tyre(sipas PZHK)

Sektori	Ndërmarrje (nr.)	%
A - Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	115	4%
B - Xehëroret dhe gurëthyesit	6	0%
C - Industria përpunuese	288	11%
D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	7	0 %
E - Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	18	1%
F – Ndërtimtaria	331	12%
G - Tregria me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	797	30%
H - Transporti dhe magazinimi	257	10 %
I - Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	185	7 %
J - Informimi dhe komunikimi	53	2%
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	11	0%
L - Aktivitetet e patundshmërive	13	0%
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	142	5 %
N - Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	129	5 %
O - Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social obligativ	1	0%
P – Arsimi	26	1%
Q - Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	65	1%
R - Arti, argëtimi dhe rekreimi	57	2%
S - Aktivitetet tjera shërbyese	160	6 %
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallëra të padiferencuara- dhe shërbime-aktivitetet prodhuese të ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	0	0%
U - Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0	0%
Gjithsej:	2661	100%

4.24. Bujqësia

Edhe pse Bujqësia është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë së Komunes prodhimi bujqësor në këtë rajon është mjaft i ulët në raport me kushtet agroekologjike, potencialet të mundshme prodhuese dhe produktiviteti përkatës që haset në vendet e zhvilluara. Prodhimtaria bujqësore, dallohet, përveç tjerash edhe me investimet paraprake relativisht të larta, dhe kthimin e tyre për një periudhë relativisht të gjatë. Duke i ditur vështirësitë e banorëve të fshatrave, është i njohur fakti se mundësitë e tyre për investime diç më serioze janë fare të vogla.



Prandaj duhet nga komuna që të perkrahët ky sektorë me grante dhe iniciativë tjerë stimuluse dhe të ruhët toka bujqësorë. Orientimi i zhvillimit të qendrueshëm do të mundësonte zvogëlimin e pa punësishë, rritjen e mirëqenjes së dhe permisimit të shëndetit duke prodhuar produkte vendore me standarde të kontrulluara. Kjo zonë është e planifikuar për shfrytëzim bujqësor. Zona ofron hapësirë për zhvillim të bujqësisë dhe blegtorisë, respektivisht pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë, kultivimin e bimëve foraxhere dhe mjekuese, fidanishtet, si dhe bletarisë. Në të njëjtën kohë, zona do të akomodojë shfrytëzime tjerë të cilat janë në shërbim të zonës, si ndërtesat bujqësorë ku përfshihen: fermat për kultivimin e kafshëve të trasha, ferma të shpezëve, ndërtesa bujqësorë përcjellëse për bagëti dhe shpezëtari, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësorë të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësorë, pleme, hambar, ahur, bodrume të verës, hapësira për makineritë dhe pajisjet bujqësorë dhe peshkim.

4.25. Turizmi

Komuna e Lipjanit karakterizohet me një sërë kapacitetesh të veçanta turistike të cilat frekuentohen në masë të madhe dhe vazhdimisht, si për aspektin edukativ, po ashtu edhe për kulturë dhe rekreacion. Ndër veçoritë më karakteristike turistike të komunës janë:

- Shpella e Mermertë e Gadimes;
- Parku nacional “Blinaja”;
- Qyteza e Janjevës dhe
- Lumi Sitnica.

Zona malore e komunës shquhet me potencial të madh të turizmit të bazuar në natyrë, si Rezervati Blinaja, bukuritë e peizazheve Shalë-Kleqkë dhe vargmalet e Zhegovcit. Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore paraqesin ndër pikat e atraksioneve turistike. Gjithashtu, Shpella e Mermertë në Gadime, si qendër e kosovare e monumentit natyror, është një atraksion i veçantë kombëtar dhe ndërkombëtar.

Qyteza e vjetër e Janjevës karakterizohet me monumente dhe objekte të tjerë të vjetra duke e bërë atë një lokalitet të shkëlqyeshëm turistik, si dhe me objekte të kulteve fetare, siç është Xhamia e Murat Beut, e cila është e vjetër rreth 400 vjet, dhe Kisha Katolike Shën Nikolla, që është ndërtuar rreth vitit 1856, e që janë me njëra-tjetrën në afërsi prej 100



metra.10 Përpos kësaj, në këtë qytezë mbahet edhe aktiviteti i përvitshëm i orëve letrare “Shtjefën Gjeqovi”.

Turizmi rural i komunës është i lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në zonat e larta ekzistojnë familje që posedojnë ferma, të cilat ofrojnë edhe shërbime të akomodimit, duke dhënë me qira dhoma ose shtëpi të vogla për ata që dëshirojnë të shfrytëzojnë shërbimet cilësore të bujqësisë dhe blegtorisë, natyrës dhe gjahut.

Në fillim të vitit 2022 komuna ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Unionin e Turizmit të Kosovës, nga i cili memorandum Komuna përfiton bashkëpunime në projekte të ndryshme që ndërlidhen me turizmin. Komuna do të ketë mundësinë e pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare të turizmit me qëllim të promovimit të turizmit të saj, si dhe do të ketë bashkëpunime mes të dy palëve me qëllim të përfshirjes së komunës në sa më shumë paketa turistike të cilat do të përpilohen nga tour-operatorët në nivel vendi. Po ashtu, në aplikacionin e vetëm në Kosovë për turizëm, “Think Kosova”, Komuna e Lipjanit bën pjesë me një kartelë të veçantë, ku përmes një guidë paraqiten resurset e saj turistike bashkë me informatat.

Sipas ARBK-së, në komunën e Lipjanit aktualisht veprojnë 415 njësi akomoduese përfshirë këtu edhe njësitë e tjera të shërbimeve që hyjnë në këtë kategori. Numri i përgjithshëm i të punësuarve llogaritet të jetë 934 punëtorë.

5. VLERËSIMI MJEDISOR I SKENARËVE ZHVILLIMORË

PZHK-ja iu ka nënshtruar një procesi interaktiv gjatë të cilit ekspertët dhe personeli i komunës kanë hartuar tre skenarë alternativë zhvillimorë. Secili skenarë e përcakton një kornizë zhvillimore për modelet e ndryshme të shfrytëzimit të tokës dhe mundësive të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Në vijim janë përshkruar këta skenarë si dhe janë testuar se sa ata i përmbushin parimet e qëndrueshmërisë dhe objektivat mjedisor.

Ne menyre te veqante Komuna e Lipjanit nuk ka zona te caktuar ligjrishte te përdorimit te tokës, kështu qe investitorët dhe banoret e zonës se studimit janë ne gjendje te zhvillojnë qdo aktivitet ekonomik pa pasur kufizime me përjashtim te disa kufizimeve qe egzistojne ne legjislacionin aktual.



Të trija skenarët kanë një parim të përgjithshëm të zhvillimit hapësinor të Lipjanit, një komunë me territor rrafshinor dhe kodrinor, që kërkon të ndërtohet mbi një model të rritjes kompakte, ku për dallim nga skenari 1 dhe 3 që promovojnë shpërndarje hapësimore të zhvillimeve, skenari 2 mbështetë një zhvillim monocentrik

Te Skenari I Është parapare zhvillimi i vendbanimeve me konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik me infrastrukturë të zhvilluar dhe zhvillime kompakte në komunën e Lipjanit. Për plotësimin e rrjetës urbane të vendbanimeve me funksione dhe përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Lipjanit, vlerësohet prioritare zhvillimi i shpejtë i qytetit të Lipjanit Janjevës, Sllovisë, Shalës, Gadimeve si dhe Magurës si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit si dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomik e mjedisore. Ne fig.7 shifet Skenari I i konceptit policentrik i cili ka pasë konceptin e Sigurimin e infrastrukturës bazike për fshatra ; Zhvillim dhe mbrojtje e tokës bujqësore ; Rritje e komunës në mënyrë të qëndrueshme; Zhvillim ekonomik, social dhe mjedisortë qëndrueshëm dhe të baraspeshuar; Ofrim të shërbimeve dhe mundësive sa ma afër, shpejtë dhe lirë për qytetarët.




Figura 7. Koncepti i zhvillimit hapësinorë - Skenari I

Skenari 2, ka zhvillimin e komunës së Lipjanit si një qendër monocentrike, si një qendër e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Kosovës me qasje dhe lidhje të mira të Lipjanit me korridoret nacionale dhe ndërkombëtare të transportit, si dhe zhvillimin e infrastrukturës së transportit modern dhe intensiv, siç janë transporti me trena dhe metro, që do të ndërlidhin Lipjanin me qendrat e tjera të Kosovës si Prishtina dhe Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari".

Ky skenar përmban dhe ide për zhvillimin e turizmit në komunën e Lipjanit, ku zhvillimi i ekosistemeve dhe zhvillimi i turizmit në malet e Zhegovcit dhe në malet perëndimore do të kenë një rol të rëndësishëm




Figura 8. Skenari II- zhvillimin e komunës si një qendër monocentrike

Skenari 2, ka zhvillimin e komunës së Lipjanit si një qendër monocentrike ka perapsi ne:

- Zhvillim i fuqishëm i Zonës Urbane,
- Ruajtja e tokës bujqësore, resurseve natyrore,
- Mundëson zhvillim të zonave turistike,
- Zhvillim ekonomik të qëndrueshme (korridorezhvillimore, zonat ekonomike),Infrastrukturë rrugore, hekurudhore dhe ajroremoderne dhe të integruar.

Skenari 3 është një skenar policentrik i zhvillimit, i cili nënkupton një zhvillim të qëndrueshëm dhe të koordinuar të të gjitha zonave të komunës së Lipjanit. Ky skenar paraqet perpsari ne;

- Zhvillim i komunës në nivel të qëndrueshëm dhebalancuar në të gjitha fushat,
- Siguron jetesë cilësore, me të gjitha funksionet përnjë urbanizëm të qëndrueshëm,
- Zhvillim policentrik të shërbimeve më planifikim tënën-qendrave të rendit të dytë,
- Ofrim më të lehte dhe kosto të ulët të shërbimevendaj qytetarëve,
- Zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të resurseve natyrore,
- Zhvillim dhe mbrojtje të tokave bujqësore dhe resurseve pyjore,



Komuna e Lipjanit Rejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit

KOMUNA E LIPJANIT

- Zhvillimi i zonave turistike me potencial,
- Zhvillim ekonomik të hovshëm përmes zonave ekonomike, korridoreve zhvillimore dhe zonave industriale,
- Institucione publike dhe sociale me shpërndarje të vëllimshme dhe gjithëpërfshirëse, Infrastruktura rrugore dhe teknike të organizuar dhe gjithëpërfshirëse.




Figura 9. Skenari III Zhvillim policentrik

Vlersimi i Skenareve

Skenaret PZHK	Kriteret e Forta Mjedisore VSM	Pershtashmeria me PH te Kosoves dhe PZhK Komunat tjera
Skenari I	+	Nuk eshte ne konflikt
Skenari II	++	Nuke eshte ne konflikt
Skenari III	++	Nuke eshte ne konflikt

Te gjith Skenaret e pariqiture ne Draft e PZHK kane marre parasysh kriteret e forta mjedisore dhe skenaret II dhe III kan ndikim me te me te madhe pozitive ne plotesimin e kriterëve mjedisore duke marre parasysh costan finaciare te zbatimit te skenari i III i propozuar ne draft e PZHK per Lipjan.

Te gjith Skenaret jane ne perputhje me PH te kosoves dhe nuk kan konflikte me PZHK te komunave tjera por ka mundsi bashkpunimi sidomos ne Trajtimin e ujrave te Zeza ne kyqjen ne ITUZ me F. Kosoven dhe Prishtinen per mes KRU Prishtina

6. PËRSHKRIM I PËRGJITSHËM I PLANIT

6.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore e natyrore.

Po ashtu, ky dokument ka për qëllim që të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët. Ky dokument, gjithashtu synon Zbatimin e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm gjatë hartimit dhe zbatimit të PZHK-së.

Është mjaft e rëndësishme të thuhet, se dokumenti do të zhvillojë te Korniza e Zhvillimit Hapësinor qëllimet dhe objektivat specifike, gjithnjë të bazuara në qëllimet dhe objektivat e planeve e strategjive të nivelit lokal dhe qendror, duke i analizuar më pas në një proces, për të

jetësuar atë që u shkrua më lartë.

;

6.2. Arsyetimi Ligjor, Mjedisor, Ekonomik, Financiar Dhe Social

Duke marrë parasysh që VSM-ja është dokument i planifikimit i bazuar në PZHK-në e komunës përkatëse, permbajta në mes të këtyre dy dokumenteve është vlerësuar si mjaftsfiduese gjatë hartimit. Për të hartuar një VSM sa më të saktë, gjatë ndarjes së territorit tëkomunës së Lipjanit në zona, si koncepti themelor i VSM të Komunës, janë marrë përbazë parimet e zonimit të përcaktuara me nenin 5 të udhëzimit administrativ nr. 24/2015. Këtoparime përfshijnë:

- Promovimin e objektivave të planeve zhvillimore sektoriale;
- Promovimin e objektivave të komunitetit;
- Promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike dhe të mirëqenies së përgjithshme;
- Sigurimin e llojllojshmërisë së shfrytëzimeve dhe dendësive;
- Sigurimin e nevojave të interesit publik;
- Sigurimin e zhvillimit të planifikuar të bazuar në :
 - gjendjen ekzistuese (marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtatpronësore);
 - nevojën për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural;
 - karakteristikat natyrore të tokës;
 - kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve;
 - vlerat natyrore dhe kulturore të komunës dhe
 - çdo model të shfrytëzimit të tokës të bazuar në Planin Zhvillimor Komunal.

Gjithashtu, janë përditësuar të gjitha të dhënat duke përfshirë këtu edhe hartën e shfrytëzimit të tokës bazuar në gjendjen faktike në terren, planet sektoriale nga drejtoritë dheinstitucionet përkatëse.

Arsyetimi për ndarjen zonale bazohet në 3 kritere bazë për identifikim të zonave:

1. Inventarizimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese, edhe atë:

- Integrimi i kërkesave të PZHK-së, mbrojtje të sipërfaqeve bujqësore, pyjore,

kufijve të zonës urbane, vendbanimeve rurale, etj;

- Listimin/ evidentimin e zbatueshmërisë së të gjithë projekteve/ investimeve kapitale nga PZHK-ja;
- Nxjerrjen e kufirit të zonës urbane dhe kufijve për zhvillime të reja për zonën rurale/ fshatrat nga zonat e vendbanimeve dhe zonat e zhvillimit të ardhshëm të parapara me Planin Zhvillimor Komunal dhe duke integruar planet rregulluese që janë në fuqi ligjore;
- Inventarizimin e të gjithë rrugëve ekzistuese, shfrytëzimeve të parcelave, ndërtimeve (perimetri dhe etazhiteti) ekzistuese në zonën urbane dhe rurale;
- Inventarizimi I të gjithë ndërtesave/ parcelave me shfrytëzim infrastrukture publike dhe sociale, dhe kalkulimin e nevojave të ardhshme për infrastrukturë publike dhe sociale sipas normave teknike të planifikimit hapësinor;
- Diskutime të hapura me qytetarë/ Mbajtja e takimeve të hapura me qytetarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

2. Klasifikimi dhe analiza e strukturave të vendbanimit dhe dinamika socio-ekonomike e komunës.

3. Potencialet për zhvillimin të ardhshëm:

- Analizë të banorëve në Lipjan për secilin vendbanim, koncentrimin në lagje, migrimit, etj.
- Kukulimin e densitetit ekzistues të banorëve në zonën urbane dhe vendbanimeve rurale dhe analiza e shtimit të fondit ndërtimor kundrejt densitetit maksimal të banorëve të përcaktuar në PZHK;
- Analizimin e të gjithë parcelave kadastrale në zonën urbane sipas pozicionit, madhësisë, formës dhe qasjes;
- Kukulim të shtrirjes së shfrytëzimeve të tokës, densitetit të banorëve, intensitetit të zhvillimit dhe fondit ndërtimor, etj. dhe integrimin të gjendje ekzistuese;
- Analizë e kapacitetit ekzistues ndërtimor vs të lejueshëm sipas PZHK- së;

- Analizë e kapacitetit pranues të zhvillimit/ ndërtimeve të ardhshme në zonën urbane. Edhe pse qyteti karakterizohet nga një fond ndërtimor mjaft homogjen, fakti që janë zhvilluar në mënyrë spontane, paraqitet nevoja të përcaktohen dhe theksohen karakteristikat kryesore të këtyre zonave të ndryshme brenda vendbanimeve si mjet për të forcuar karakterin e tyre. Gjithashtu, për gjithë zonën urbane është propozuar zhvillim për secilën prej zonave përmes të cilave synohet përmirësimi dhe promovimi i tipareve dhe resurseve.

Përveq obligimeve të derivuara nga PZHK-ja, janë integruar edhe Planet Rregulluese Urbane të cilat kanë dëshmuar zbatim të suksesshëm dhe që janë në fuqi ligjore, bazuar në UA nr. 24/2015 neni 5, pika 5, ku parashihet mundësia e integritit të këtyre planeve në fuqi.

Për shkak se në shumë raste, ndarjet zyrtare të parcelave kadastrale nuk korrespondojnë aspak me gjendjen fizike dhe faktike në terren, për analizë dhe propozim të zhvillimit të ri, jemi bazuar edhe në kriterin e morfologjisë urbane fizike në terren.

Përveç tjerash, gjendja ekzistuese është konsideruar si parim kyç për përcaktimin e sipërfaqeve ndërtimore, duke zgjeruar këto sipërfaqe edhe përtej kufijve të parashikuar me PZHKP. Me këtë zgjerim të sipërfaqeve ndërtimore në zonat rurale, planifikohet zhvillimi i kontrolluar i zonave të shfrytëzuara për ndërtim në këto zona, duke ofruar kushte më të mira për jetesë dhe infrastrukturë të përshtatshme për shfrytëzim nga banorët e vendbanimeve rurale.

6.3. Konkluzionet rreth kontekstit mjedisor

Prej analizës së VSM-së dalin këto përfundime:

Të dhënat e popullsisë nuk janë të besueshme dhe është e vështirë të bëhet ndonjëparashikim për ekonominë familjare, shërbimet publike dhe infrastrukturën; komuna në bashkëpunim me autoritetet shtetërore duhet të bëjë anketa për vlerësimin e saktë të numrit të banorëve, shkallën e shtimit, numrin e parashikuar të personave të zhvendosur që mund të kthehen në komunën etj;

– Shërbimet publike kryesisht financohen nga institucionet komunale; edhe pse kapacitetet e tyre mund t'i përmbushin nevojat, objektet në të cilat funksionojnë këto shërbime duhet të riparohen dhe të mirëmbahen si duhet;

– Cilësia e ajrit është e përkeqësuar si rezultat i pluhurit që vjen nga deponia e mbeturinave të minjerave ; transporti , ngrohja dhe nën kushte të veçanta klimatike, ndotja e ajrit nga termocentrali i Obiliqit përhapet edhe në territorin e komunës ;

– Deponia e xeheve të Kishnicës është burim i ndotjes: gjatë motit me erë pluhuri përhapet deri në zona të largëta; uji që rrjedh nëpër deponi dhe që depërton në tokë e ndot atë dhe ujin nëntokësor, ndërsa sedimentet përmes erozionit barten në lumin Graçanka;

– Kur kemi të bëjmë me burimet minerare, duhet të merren parasysh pasojat (negative) mjedisore të rifillimit potencial të punës në minierën ekzistuese të Kishnicës.

– Toka bujqësore, uji dhe xehet e plumbit e zinkut janë burime më të rëndësishme në komunë.

Ndërsa toka bujqësore me dheun e cilësisë së lartë i nënshtrohen presioneve të ndryshme për ndërrimin e destinimit të saj për qëllime jo prodhuese. Cilësia e dheut nuk është studiuar mjaftueshëm në këtë komunë. Mbrojtja e tokës bujqësore së bashku me ruajtjen e dheut cilësor duhet të jetë prioriteti kryesor i komunës.

– Burimet e ujit nuk janë të shënuara si duhet: nuk ka të dhëna për sasinë mesatare, maksimale dhe minimale të ujit të lumenjve, e as nuk ka informacione për rezervat e ujit nëntokësor (thellësia e ujit, sasia, shkarkimi, etj.). Duhet të bëhen analiza të mëtejme me qëllim që të përkufizohen si duhet politikat e furnizimit me ujë në të ardhmen, si dhe ato të ujitjes. Përveç kësaj, është me rëndësi edhe hidrologjia e lumenjve për të vendosur përmetodat më të mira të rregullimit të lumenjve si pjesë të politikave të ardhshme sa i përket mbrojtjes nga vërshimet. Vetëm pas një studimi për burimet e ujit, komuna mund të vendos për mënyrën më të mirë të sigurimit të furnizimit me ujë dhe për ujitje.

– Burimet biologjike janë mjaft të pakta: pyje të kufizuara dhe jo shumë të vlefshme në aspektin ekonomik, pastaj stoqet në rënie të sasisë së peshkut për shkak të cilësisë së dobët të ujit të lumenjve, mos monitorimit dhe mungesës së mbrojtjes së kafshëve të egra edhe përkundër planeve të komunës për krijimin e rezervateve të gjuetisë; kjo nënkupton se komuna duhet të punojë në restaurimin e burimeve biologjike në mënyrë të organizuar.

7. PARIME, OBJEKTIVE E KRITERE MJEDISORE

7.1. Objektivat e VSM-së për PZH Komunale të Lipjanit

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë PZHK-së së Lipjanit, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë për Planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri: Përmbushja e objektivave afatmesme për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufijve maksimalë e normave të lejuara nga ligjet ne fuqi dhe standartet e përcaktuara

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji: Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin e komunës së Lipjanit, mbi burimet dhe trupat ujorë sipërfaqësorë e nëntokësorë, përfshirë ujin e pijshëm, lumenjtë dhe liqenet.

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe burimeve natyrore të lidhura drejtpërdrejt me të.

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të mjedisit.

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet: Konservimi, shtimi dhe manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike dhe ofrimit të një burimi të qëndrueshëm jetese për banorët e zonave rurale.

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet: Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike: Realizimi i masave dhe infrastrukturës përtë mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike, në përmbushje edhe të angazhimeve përkatëse kombëtare.

Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi për jetëgjatësi i objekteve dhe zonave historike e të trashëgimisë kulturore e arkeologjike.

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Cilësia e jetës: Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilesisë së jetes në komunë (rritja e sigurise, shtim i mundësive për menyre aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operationale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM-ja e PZHKL, parashikon kushte dhe masa zhvillimore për Komunën e Lipjanit, si një e tërë me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këtë fazë, Projekti i PZH të Komunës së Lipjanit, do jepen kufijt, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standartet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim përmes kushteve zhvillimore dhe masavetjera. Sfidues është fakti nga se sa do të të analizohet ndikimi i këtij projekti në korridoret e qarkullimit të shtazëve ose a janë marrë masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, pyllzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve, etj. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden vetëm në pjesën strategjike. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktike i këtyre kushteve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisore të komunës.

Gjithashtu PZHK synon të integrojë dhe përmirësojë situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë më plleshmëri të

dobët dhe me perdorim të perzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i PZHK-së është masat për rehabilitimin e pikave të nxehta mjedisore (duke mos specifikuar sakt lokacionet e pikave të nxehta mjedisore por kjo është trajtuar si problem).

Në mënyre të përmbledhur objektivat për mbrojtien e mjedisit në kuadrin e Planit për ZHKL, mund të përmbledhen si më poshte:

- Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi i integruar i tyre;
- Krijimi i një komune të qendrueshme dhe të shëndetshme;
- Identifikimi dhe krijimi i habitatve të reja, dhe korridoreve të gjelbra;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë edhe reduktimin të emisioneve në ajër dhe eliminimin e zhurmës;
- Kursimi i energjisë dhe paksimi i emisioneve të gazeve sërë;
- 6. Cilësia e ujërave sipërfaqesore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivave të BE-së;
- Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me bicikleta;
- Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë arkeologjike dhe arkitekturore;
- Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
- Mbrojtja e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
- Ripërdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

7.2. Krahësimi mes objektivave të PZHK-së dhe VSM-së

Testimi i PZHK-së kundrejt objektivave mjedisore

Fushat ku ka më së shumti konflikte mes objektivave të PZHK-së dhe VSM-së janë në sektorin ekonomik dhe të infrastrukturës, kryesisht në kategoritë të shfrytëzimit të tokës.

– Përmirësimi i zhvillimit të bizneseve (industriale, depove, minierave, etj.) përmes krijimit të zonave të reja dhe/ose zgjerimit të atyre ekzistuese;

– Përcaktimi i zonave për turizëm, trashëgimi kulturore, peshkim, gjueti dhe aktivitete të tjera plotësuese komerciale;

– Ngritja e ndërtesave dhe qarqeve të reja, qofshin ato të banimit, administrative, të kujdesit shëndetësor, sportit, kulturës ose të tjera;

– Ndërtimi i infrastrukturës: rrugë/ hekurudha, furnizim me ujë (duke përfshirë penda, rezervuarë, gypa) / pastaj kanalizim, impiante për trajtimin e ujërave të zeza, impiante për trajtimin e mbeturinave dhe deponive të mbeturinave, linja mbietokësore të rrymës elektrike, kablllo optike, furnizim me gaz natyror përmes gypave, etj.

Çfarëdo shfrytëzimi i tokës që e ndryshon peizazhin natyror në tokë ndërtimore mund ta prish mjedisin nëse nuk zbatohen masa parandaluese

Projekt-Raporti perfundimtar

Raporti Përfundimtar do të jetë rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të komunës, si edhe seancave të dëgjësive me publikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet që dalin gjatë procesit, do u jepet përgjigje dhe do integrohen nëse gjykohen të drejta, dhe në fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Komuna dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

7.3. Roli dhe natyra e Planit Zhvillimor Komunal

Plani Zhvillimor Komunal i Lipjanit është dokument i cili përmes kushteve zhvillimore dhe masave përcaktone drejtimet e zhvillimit të komunës duke marrë parasysh interesat e përbashkëta të banorëve të Komunës së Lipjanit për një mirëqenie dhe një zhvillim ekonomik, duke përmirësuar kualitetin e jetes së banorëve të vet. PZHK kujdes të veçantë i kushton vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore dhe mbron resurset e këtij territori. Planifikimi hapësinor duhet të ketë rolin udhëheqës në zhvillimin e gjithëmbarshtëm prandaj kjo P Z H K e Lipjanit do të përbëjë udhëzuesin bazë për:

- *Identifikimin e lokacioneve me potencial të zhvillimit hapësinor në komunën e Lipjanit;*
- *Përcaktimin politikave përmes kushteve zhvillimore dhe masat që i jep lidhur me shpërndarjen hapësinore të funksioneve të banimit, industrisë, shërbimeve, turizmit, zhvillimit rural dhe politikave në mbrojtjen e vlerave të trashëgimive kulturore, historike dhe natyrore;*
- *Identifikimin e rolit të vendbanimeve kryesore dhe veçanërisht të qytetit të Lipjanit si qender administrative - duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe mjedisor të kësaj komune.*

PZHK përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës të planifikimit të integruar:

- Përcakton mënyrën dhe drejtimet e vendosjes së popullsisë, punësimit dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore për t'i shërbyer;
- Orienton dhe lehtëson vendimet politike për investimet publike në

infrastrukturë teknike dhe sociale;

- Përkrah zhvillim të balansuar në mes të zonave urbane dhe zonave rurale dhe me shkallëtë ndryshme ekonomike;

7.4. Identifikon lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të komunës

Kriteret mjedisore që kufizojnë Zhvillimin Komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojnë zhvillimin komunal, të grupuara në katër kategori kryesore, përkatesisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kriteret të trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peisazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

7.5. Kriteret e forta mjedisore-shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë:

- (I) Zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. Resurset ujore ,zonat e mbrojtura të natyrës, zona e mbrojtur e zogjve.
- (II) Zona të rrezikshme për zhvillim psh zona me rrezikshmeri termeteve, vërshimeve, rreshqitjeve.
- (III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike, minjerat).

7.5.1. Zonat e mbrojtura

Në Komunë ekziston disa Zona të Mbrojtura me sipërfaqe të përgjithshme prej 2431.7ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit në hektar me Zona të Mbrojtura: Blinaje, Gadime e Ulet, Kraishte, Krojmir, Leteliq, Mirene, Resinoc, Ribar i Madh, Vershec.

7.5.2. Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni
- Shtreterit e lumenjve dhe pjesët buferike rreth tyre
- Basenet nentokësore ujëmbajtëse;
- Zonat me pjerresi më të madhe.

Nuk lejohen ndertimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmytjeve (qofte dhe shumë të rralla), mund të shkaktojnë erosion të brigjeve, si dhe të cenojnë rregjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndertimet ne zonat me pjerresi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm.

7.5.3. Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike) përfshijne:

- Hotspote nga kemikatet;
- Hotspote nga aktivitetet bujqësore;
- Hotspote nga sektori i transportit;
- Hotspote nga deponitë sanitare;
- Hotspote nga sektori i industries;
- Hotspotet nga sektori minerar;
- Hotspote nga materiet radioactive.

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlersimin e situates mjedisore mbi bazën e të cilit do te mund të gjykohet mbi nivelin e ndotjes së ujit dhe tokës dhe masat eventuale që duhen ndërmarre për rehabilitimim.

7.6.Kritere të trashëgimisë kulturore

Qyteti i Lipjanit gjithmonë ka qenë udhëkryq i kulturave dhe i grupeve të ndryshme etnike dhe prandaj Lipjani pasqyron një histori të mrekullueshme të territorit të Kosovës. Ekzistojnë shumë ndërtesa të rëndësishme monumentale të trashëguara nga civilizime të ndryshme, posaçërisht nga epoka Otomane, kur qytetit fitoi rëndësi të madhe si qytet tregtar përparimtar duke ju falënderuar pozitës së tij strategjike. Qyteti i Lipjanit ka shumicën dhe llojllojshmërinë më të madhe të monumenteve dhe të lokacioneve që paraqesin sfondin historik të territorit të tij. Në Komunën e Lipjanit si klasifikim monument arkitektonik janë disa ndërtesa publike të cilat janë në shfrytëzim dhe / ose pronësi të palëve publike ose shtetërore.

8. NJOHJA DHE PARASHIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

8.1. Ndikimet mjedisore

Qëllimi i VSM-së është, ndër të tjera, të njohë, të parashikojë dhe të vlerësojë pasojat e Planit në mjedis dhe merret parasysh në kuptimin e tij të gjerë, nga këndvështrimi ekologjik, social dhe ekonomik. Plani formulon një vizion për Komunën e Lipjanit, Objektivat Strategjike që i shërbejnë këtij vizioni, si edhe Prioritetet për çdo Objektiv Strategjik Prioritet e përgjithshme përfshijnë vepra teknike infrastrukturash, vepra infrastrukturash sociale, vepra zhvillimore, veprime për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe kulturor, veprime për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, etj. Të gjitha këto propozime të Planit pritet të kenë ndikim në mjedis dhe të ndikojnë në shkallë të vogël ose të madhe, pozitivisht ose negativisht, në parametrat e ndryshme mjedisore (toka, ujërat, ajri, faktorët klimaterikë, biodiversiteti, etj).

Në paragrafët e mëposhtëm, siç u përmend edhe më parë, shqyrtohet marrëdhënia e secilit Prioritet të Projektit të propozuar me secilin faktor mjedisor, siç ata përcaktohen në Ligjin për "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor".

Prioriteti 1 që ka të bëjë me mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, lidhet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

Lidhet me tokën, për shkak se menaxhimi, sasia dhe cilësia e burimeve natyrore (burime

minerale, zonat e mbrojtura natyrore) ndikojnë në cilësinë, sasinë dhe në mbrojtjen e tokës, ndërsa vet toka në vetvete është një burim natyror i cili shfrytëzohet p.sh. në sektorin bujqësor po edhe në vendosjen e çdo aktiviteti antropogjen dhe propozon veprime që në mënyrë indirekte ndikojnë në të.

Lidhet me biodiversitetin pasi vendoset në burime natyrore si pyje, toka, ujë dhe përcaktohet nga cilësia dhe sasia e tyre.

Lidhet me mbetjet sepse mënyra e menaxhimit të tyre ka pasoja në burimet natyrore (p.sh. hedhje të mbetjeve në mjedis dhe shkatërrimi i tyre nga organizma të gjalla apo bimore), por edhe e kundërta, menaxhimi i burimeve natyrore krijon mbetje (p.sh. aktivitetet e nxjerrjes shfytëzimit dhe seperimit të gurit gëlqeror).

Shfrytëzimi i një burimi natyror përbën burim ekonomik për pjesë të popullsisë apo edhe produkt konsumi jetese. Prioriteti 1 parashikon menaxhimin racional të burimeve natyrore, në mënyrë që ata të mos zhduken në të ardhmen apo të krijojnë kushte të vështira jetese për popullsinë e Komunës.

Nxjerrja e pakontrolluar e gurëve dhe prerja e pemëve, si edhe mbi kullotja janë aktivitete që kanë pasoja në peisazh, duke ndryshuar p.sh. morfologjinë e tij, hidrografinë e tij si edhe bimësinë në një hapësirë peisazhi të caktuar. Si rrjedhim, Prioriteti 1 lidhet me peisazhin dhe parashikon mirëmbajtjen e tij apo përmirësimin e tij. Për sa i përket ajrit, faktorëve klimatikë, ujërave, zhurmave dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur për tu përcaktuar ndikimi i Prioriteti 1 tek faktorët konkret mjedisorë.

Prioriteti 2 që ka lidhje me mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të ekosistemeve pyjore, ka lidhje me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

- Lidhet me tokën, pasi marrëdhënia midis ekosistemeve pyjore dhe tokave është e dyanshme. Tokat mbështesin ekosistemet pyjore dhe ekosistemet pyjore mbrojnë tokën.
- Lidhet me ajrin pasi pyjet filtrojnë ndotësit atmosferikë dhe përmirësojnë cilësinë e ajrit
- Lidhet indirekt me faktorët klimatikë dhe në veçanti me mikroklimën e zonës në të cilën rritendhe zhvillohen.
- Lidhet me biodiversitetin, pasi pyjet posedojnë shumicën e florës dhe faunës së Komunës. Lidhet me peizazhin dhe veçanërisht me peizazhin natyror, me

veprime që e mbrojnë atë. Ekosistemet pyjore janë pjesë e peizazhit natyror.

- Lidhet me popullsinë dhe asete fizike në masën që ekosistemet pyjore përdoren në prerjen e drurëve dhe zhvillimin turistik të butë (Organizim të shëtitjeve dhe korridoreve të çiklizmit) dhesi rrjedhim në masën që mbështetin ekonominë lokale.

Për sa i përket ujit, zhurmës, mbetjeve dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur të përcaktohet një ndikim i Prioritetit 2 për këta faktorë konkretë mjedisorë.

Prioritetit 3 që ka të bëjë me mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, është i lidhur me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

- Lidhet me tokën, sepse kjo mund ose nuk mund të akomodojë burimet e ujit dhe për shkak se ujit mund të dëmtojë tokën.
- Lidhet me ujin, pasi të gjitha veprimtaritë kanë të bëjnë me përdorimin dhe shfrytëzimin e tij në dobi të sektorëve primar, sekondar dhe terciar, si dhe shëndetin e njeriut.
- Menaxhimi efektiv i burimeve të ujit do të ketë si rrjedhim të mos shfaqen dukuri mbishfrytëzimi të ujit dhe privimi të tih në zona kritike për ruajtjen e biodiversitetit. Për më tepër, infrastruktura antropogjene si për shembull rezervuarët, përdoren për ujitje, janë vende akomodimi të një faunë dhe flore të pasur. Si rrjedhim, ekziston një lidhje në mes të Prioritetit 3 dhe biodiversitetit.
- Lidhet me popullsinë dhe asetet fizike pasi uji është një pasuri e përbashkët që i përket të gjithë njerëzve pasi cilësia e tij ndikon në shëndetin e popullsisë ndërsa sasia e tij ndikon në standardin tyre të jetesës.

Menaxhimi efektiv i burimeve ujore nënkupton infrastrukturën që ndikojnë në peizazh, si për shembull ndërtimi i rezervuarëve artificialë dhe sistemit të tubacionit të ujitjes.

Për sa i përket ajrit, faktorëve klimatikë, mbetjeve, zhurmës dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i Prioritetit 3 në këta faktorë konkretë mjedisor.

Prioritetit 4 ka lidhje me mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, është i lidhur me faktorët e mëposhtëm të mjedisit:

- Lidhet me tokën pasi toka bujqësore përbën pjesë të saj në gjithë sipërfaqen e Komunës dhe për këtë arsye të gjitha veprimet ndikojnë drejtpërdrejtë në të.

- Lidhet me ujin, pasi për të është një depozitë, që e jep tek bimët, kur ato e kanë nevojë atë dhe pasi ky prioritet parashikon menaxhimin e ujit për ujitje ai parashikon ngopjen e tokës bujqësore vetëm me sasinë e nevojshme për ujë.
- Lidhet me mbetjet, pasi një pjesë e tyre mund të shfrytëzohen (mbetjet organike) dhe të përdoren në tokën bujqësore me qëllim pasurimin e saj me lëndë organike.

Toka bujqësore është një aset për një pjesë të popullsisë që e ka në atë në pronësi dhe ushtron aktivitet në sektorin primar ndërsa pjelloria e saj përcakton gjendjen e tij financiare. Për këtë arsye, është i lidhur me popullsinë, pasi synon mbajtjen e popullsisë në rajon dhe përmirësimin e standardit të tyre të jetesës.

Toka bujqësore përbëhet nga zonat gjysmë-natyrore të përbëra nga mbjellje lineare pemësh frutore, tarraca në shpatet e pjerrëta, fusha dhe parcela katrore dhe në formë mozaikësh të mbjella me kultura etj kufizohet nga kanalet e ujitjes, shirita toke të pakultivuara, përrenj natyrorë. Si rrjedhim përbën pjesë të peizazhit dhe gjendja e tij reflektohet në të.

Për ajrin, faktorët klimatike, biodiversitetin, zhurmën dhe kulturën nuk përcaktohet ndonjë ndikim në faktorët konkretë mjedisorë.

Prioritetit 5 që ka lidhje me edukimin mjedisor të komunitetit lokal, lidhet me faktorët e mjedisit si në vijim:

- Lidhet me tokën, pasi me edukimin mjedisor shoqëria lokale do të adaptojë praktikat bujqësore që e mbrojnë dhe e ruajnë atë.
- Lidhet me ujin pasi me edukimin mjedisor komuniteti lokal do të mësojë përdorimin racional të ujit dhe në të njëjtën kohë, do të jetë e mundur marrja e masave për të mbrojtur pronat e tyre nga përmbytjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore që lidhen me ujin.
- Lidhet me mbetjet, pasi me edukimin mjedisor komuniteti lokal do të mësojë të menaxhojë mbetjet shtëpiake në favor të tij (p.sh. ndarja e mbetjeve organike në burim, riciklimi i materialeve të ndryshme etj).
- Lidhet me popullsinë dhe asetet aktive, pasi gjithë veprimet kërkojnë përfshirjen e gjithë komunitetit lokal, i cili përmirëson nivelin njohës, dhe përfshihet në mënyrë aktive në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shfrytëzimin e aseteve të tij.

Për sa i përket ajrit, faktorëve klimatikë, biodiversitetit, zhurmave, trashëgimisë kulturore dhe

peisazhit, nuk është e mundur për tu përcaktuar ndikimi i Prioritetit 5 tek faktorët mjedisor.

Prioritetit 6 që ka lidhje me zhvillimin turistik të rajonit, ka lidhje me faktorët e mëposhtëm mjedisorë :

- Lidhet me tokën, pasi ajo përbën pritësin e aktiviteteve agroturistike, dhe në mënyrë të veçantë gjithë veprimet e propozuara që kanë lidhje me praktikatat bujqësore dhe veprimet e tjera të lidhura me njësitë agroturistike.
- Lidhet me ajrin pasi synon rritjen e vizitorëve në monumente kulturore dhe natyrore të Lipjanit dhe si pasojë do të rritet edhe lëvizja e transportit privat dhe publik për/dhe nga monumentet. Në varësi të formave alternative të turizmit mund të përdoren mjete të ndryshme transporti, me mëpak ose më shumë shkarkime të ndotësve në atmosferë.
- Lidhet me ujërat, pasi do të sjellë ndryshime në kërkesën për ujë, me një kërkesë paralele për një menaxhim më racional të tij, kështu që pritet të ndikojë në burimet ujore sipërfaqësore.
- Lidhet me mbetjet, pasi do të sjellë ndryshime në sasinë e mbeturinave të prodhuara, për arsye tëturizmit dhe për këtë arsye do të ketë nevojë për menaxhimin e duhur.
- Lidhet me zhurmën, pasi lëvizjet dhe përqëndrimet e turistëve pritet të shkaktojnë zhurmë, kështu që do të ketë ndikim në mjedisin akustik.
- Lidhet me peizazhin, pasi elementët e trashëgimisë kulturore përbëjnë pjesë përbërëse tëpeizazhit, edhe zhvillimi i formave alternative të turizmit është i lidhur me peizazhin.
- Lidhet me trashëgiminë kulturore, pasi në të do të bazohet një pjesë e madhe e potencialit tëardhshëm turistik të Komunës.

Prioriteti 6 parashikon rritjen e ekonomisë lokale dhe si rrjedhim, lidhet me standardin e jetesës së banorëve dhe me gjendjen e tyre financiare. Nga një këndvështrim më i gjerë, kjo do të ketë ndikim edhe në rritjen e popullsisë së Lipjanit, pasi krijimi i vendeve të reja të punës do të ndikojë në fenomenin e migrimit, veçanërisht të të rinjve.

Përsa i përket faktorëve klimatikë dhe biodiversitetit, nuk është e mundur përcaktimi i ndikimit tëPrioritetit 6 në faktorët konkret mjedisor.

Prioritetit 7 ka të bëjë me modernizimin dhe forcimin e prodhimit primar, është i lidhur me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

- Lidhet me tokën, sepse kjo është baza për zhvillimin e prodhimit primar pasi mbështet dhe ushqen bimët u kultivuara, dhe ndërkohë pranon praktikat bujqësore të ndryshme, të mira apo të këqija.
- Lidhet me ujin pasi prodhimi primar rrit kërkesën për ujë edhe nëse ai është përdorur për ujitje kultivave apo si ujë i pijshëm për bagëtinë, por edhe për shkak se në qarkullimin e ujit përfundojnë mbetjet nga përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike.
- Lidhet me biodiversitetin në atë masë që do të miratohet apo jo multikultivimi i produktet lokale dhe bujqësisë organike, si edhe në masën që sektori primar do të përhapet në hapësirën e rajonit të Lipjanit.
- Lidhet me mbetjet pasi sektori primar prodhon mbetje por edhe mund ti shfrytëzojë mbetje si për shembull mbetjet organike të ngurta urbane të cilat përmes procesit të kompostimit mund të përdoren për pasurimin e tokës bujqësore me material organik.
- Lidhet me popullsinë dhe me asetet fizike, pasi kërkon një minimum të fuqisë punëtore dhe përmasë popullsie, me synim që sektori primar të zhvillohet më tej, ndërsa kërkon edhe investime në makineri, magazina, sera, etj, duke ndikuar kështu në faktorin e aseteve fizike.
- Lidhet me peizazhin, pasi zhvillimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore, krijon imazhe karakteristike të zonave gjysmë natyrore të përbëra nga pemishte të mbjella në mënyrë lineare, tarraca në shpate të pjerrëta, parcela katrore në ultësira të mbjella me kultura bujqësore etj që kufizohen nga kanale ujitëse, parcela të pakultivuara, shirita të papunuara, përrrenjë natyrorë, elementë ndërtimi të peizazhit rural.

Përsa i përket ajrit, faktorëve klimatik, zhurmën dhe trashëgiminë kulturore, nuk ka asnjë provetë një impakti të këtij prioriteti mbi këta faktorë mjedisor.

Prioriteti 8 lidhet me forcimin e sektorit dytësor dhe tregtisë, shoqërohet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

- Lidhet me ajrin pasi tregtia është drejtpërdrejt e lidhur me sektorin e transportit dhe ndotjen e ajrit;
- Lidhet me ujin që do të përdoret në impiantet e përpunimit p.sh. në pastrimin e produkteve bujqësore;
- Lidhet me mbeturinat, pasi impiantet e përpunimit do të prodhojnë mbeturina, lëndë të

ngurta ose lëngje që duhet të menaxhohen;

- Lidhet me zhurmën e shkaktuar nga njësitë e përpunimit, por natyrisht varet nga madhësia e njësisë, nga pajisjet mekanike dhe nga produkti i prodhuar. Sidoqoftë, është fakt përdorimi i makinerive në njësitë e përpunimit.
- Lidhet me popullsinë dhe me asetet fizike, pasi ky prioritet synon rritjen e ekonomisë lokale dhe si rrjedhim rritjen e standardit të jetesës së banorëve, dhe si rrjedhim rritjen dhe përmirësimin e gjendjes së tyre financiare, ku do të përfshihen dhe infrastruktura e nevojshme dhe ndërtesat e përpunimit.

Si rrjedhim, kjo ka ndikim edhe në zhvillimin e popullsisë së Komunës së Lipjanit.

Do të ketë një ndikim në peizazh, pasi në zhvillimin e aktiviteteve prodhuese përfshihet edhe ndërtimi i ndërtesave dhe infrastrukturës së nevojshme për përpunimin e produkteve bujqësore primare.

Për sa i përket tokës, faktorëve klimaterik, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur të përcaktohet një ndikim i Prioritetit 8 për faktorët konkretë mjedisorë.

Prioriteti 9 ka lidhje me mbrojtjen , promovimin dhe reklamimin e gjithë monumenteve arkeologjike- kulturore të Komunës, lidhet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

- Lidhet me ajrin pasi synon rritjen e vizitueshmërisë së monumenteve dhe si pasojë, rritjen e lëvizjes së mjeteve të transportit publik dhe privat për/dhe nga monumentet. Mjetet e transportit konsumojnë energji dhe çlirojnë ndotës që shkarkohen në atmosferë.
- Lidhet me zhurmën në mënyrë indirekte, pasi lëvizjet dhe përqëndrimet e turistëve shkaktojnë zhurmë.
- Lidhet me peizazhin, pasi ndërhyrjet që propozohen janë, ndërmjet të tjerash, të ndjeshme (p.sh. rinovimi i objekteve me vlera kulturore dhe zonat përreth monumenteve).
- Do të ketë ndikim në trashëgiminë kulturore, pasi Prioriteti 9 synon rritjen e trafikut në monumentet e kulturës dhe në vendet arkeologjike të rajonit për të cilat propozohen projekte rihvillimi, ruajtjeje dhe përdorimi.

Do të ketë ndikim të Prioritetit 9 në popullsi dhe në asetet aktive, pasi do të ketë ndikim në biznesin profesional dhe në mundësitë e komunitetit lokal, përmirësimin e ekonomisë lokale,

përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë dhe si rrjedhim në përmirësimin e gjendjes së tyre financiare. Në një këndvështrim më të gjerë, do të ndikojë edhe në rritjen e popullsisë së Komunës.

Për sa i takon tokës, faktorëve klimatikë, ujërave, biodiversitetit dhe mbetjeve, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i Prioritetit 9 në faktorët konkret mjedisorë.

Prioritetit 10 ka lidhje me forcimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e hapësirave kulturore dhe të veprimtarive të reja kulturore, lidhet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

- Lidhet me ajrin pasi synon rritjen e vizitorëve në monumenteve dhe si pasojë, rritjen e lëvizjes së mjeteve të transportit publik dhe privat për/dhe nga monumentet. Mjetet e transportit konsumojnë energji dhe çlirojnë ndotës që shkarkohen në atmosferë.
- Lidhet me zhurmën në mënyrë indirekte, pasi lëvizjet dhe përqëndrimet e turistëve shkaktojnë zhurmë.
- Lidhet me peizazhin, pasi ndërhyrjet që propozohen janë, ndërmjet të tjerash, të ndjeshme (p.sh. rinovimi i objekteve me vlera kulturore dhe zonat përreth monumenteve).
- Do të ketë ndikim në trashëgiminë kulturore, pasi Prioriteti 10 synon rritjen e trafikut në monumentet e kulturës dhe në vendet arkeologjike të rajonit për të cilat propozohen projekte rrizhvillimi, ruajtjeje dhe përdorimi.
- Do të ketë ndikim të Prioritetit 10 në popullsi dhe në asetet aktive, pasi do të ketë ndikim në biznesin profesional dhe në mundësitë e komunitetit lokal, përmirësimin e ekonomisë lokale, përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë dhe si rrjedhim në përmirësimin e gjendjes së tyre financiare. Në një këndvështrim më të gjerë, do të ndikojë edhe në rritjen e popullsisë së Komunës së Lipjanit.

Për sa i takon tokës, faktorëve klimatikë, ujërave, biodiversitetit dhe mbetjeve, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i Prioritetit 10 në faktorët konkret mjedisor.

Prioritetit 11 që ka lidhje me përmirësimin/modernizimin e rrjeteve të shërbimeve me interes të përbashkët (ujësjellës, kanalizime, energji, menaxhim të mbetjeve) në qytet dhe në vendbanimet tjera, dhe me përmirësimin e infrastrukturës teknike mjedisore, lidhet me faktorët e mjedisit si në vijim:

- Lidhet me tokën, që përbën tregues marrësin e ujit të pijshëm – ujërave të zeza nga rrjedhjet

në sistemet e furnizimit me ujë – kanalizimeve, si edhe është tregues i gjendjes së pakontrolluar të mbetjeve kur rrjetet e përfitimit të përbashkët nuk ekzistojnë apo funksionojnë keq.

- Uji lidhet me Prioritetit 11, përsa i përket ekonomizimit të tij në rrjetet e furnizimit me ujë dhe mbrojtjes së burimeve ujore të cilat sot janë treguesë të ujërave të zeza të vendbanimeve.

Biodiverziteti mund të ndikohet nga ndërtimi i rrjeteve urbane të infrastrukturave, pasi një pjesë e tyre ndërtohen gjithmonë jashtë rrjetit urban.

Mbetjet, të lëngëta dhe të ngurta, lidhen me Prioritetin 11, ndërsa menaxhimi i tyre arrihet vetëm nëpërmjet një sistemi të plotë reduktimi, parandalimi, riciklimi, kompostimi, groposjeje, përmbetjet e ngurta dhe përpunimit dhe gjendjes për mbetjet e lëngëta (ujërat e zeza të vendbanimeve).

Përmirësimi dhe modernizimi i rrjeteve urbane të interesit të përbashkët do të shkaktojë ndikime në cilësisë e jetës së qytetarëve dhe zonat e banuara, ato do të jenë zona më tërheqëse urbane, kështu që do të ketë ndikim si në faktorin mjedisorë të popullsisë ashtu edhe në asetet aktive.

Përsa i përket ajrit, faktorëve klimaterikë, peisazhit, trashëgimisë kulturore dhe zhurmës, nuk është e mundur të përcaktohet ndikim i Prioritetit 11 në faktorët konkretë mjedisorë.

Prioritetit 12 që ka lidhje me përmirësimin e dhe modernizimin e infrastrukturës së transporteve, lidhet me faktorët mjedisorë si në vijim:

- Lidhet me ajrin, pasi ndryshon të dhënat e qarkullimit p.sh. ngarkesat në qarkullim dhe në këtë mënyrë, ndikon në cilësinë dhe sasinë e ndotësve atmosferikë që emetohen nga automjetet.
- Lidhet indirekt me faktorët klimaterikë si rezultat i korrelacionit të tyre me ajrin.
- Lidhet me zhurmën, pasi kjo është drejtpërdrejt e lidhur me sektorin e transporteve dhe kushtet e qarkullimit që mbizotërojnë dhe meqë Prioritetit propozon forma alternative lëvizjeje (p.sh. biçikleta) dhe ndërhyrje në akset rrugore, do të ketë ndikim edhe në mjedisin akustik.

- Lidhet me popullsinë, pasi ndërhyrjet e mundshme do të kenë si qëllim përfundimtar lehtësimin e banorëve dhe përdorimin nga aspekti teknologjik të mjeteve të mëparshme të transportit që përbëjnë elementë pasurorë materialë për Komunën dhe për banorët e saj.
- Lidhet me trashëgiminë kulturore, pasi ka të bëjë me lidhjen dhe aksesin ndër të tjera, edhe të monumenteve kulturore të Lipjanit.
- Lidhet me peisazhin, ndërsa çdo ndërhyrje në rrjetin rrugor (ndërtimi i nyjave rrugore, i arterieve të reja rrugore, shndërrimi i rrugëve të fshatit në rrugë të asfaltuara, etj.) reflektohen në peisazh. Përsa i përket tokës, ujit, biodiversitetit dhe mbetjeve, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi Prioritetit 12 në faktorët konkretë mjedisorë.

Aksi i Prioritetit 13 që ka lidhje me përmirësimin e infrastrukturës sociale, lidhet me faktorët mjedisorë si në vijim:

- Lidhet me popullsinë dhe elementët pasurorë materialë, pasi shërbimet e arsimit përmirësojnë nivelin e dijeve të qytetarëve dhe për pasojë, mundësitë profesionale të banorëve dhe sjelljen e tyre mjedisore, ndërsa kujdesen për rritjen e pritshmërisë së jetës së tyre.
- Në vazhdim, popullsia e Komunës bëhet akoma më shumë konkurruese nga aspekti ekonomik edhe më shumë aktive, dhe ka shanse rritjeje të nivelit të jetesës.

Përsa i përket tokës, ajrit, faktorëve klimaterikë, ujit, biodiversitetit, mbetjeve, zhurmës, trashëgimisë kulturore dhe peisazhit, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i Aksit të Prioritetit 13 në faktorët konkretë mjedisorë.

Prioritetit 14 që ka lidhje me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit të strukturuar/ rezidencial, lidhet me faktorët mjedisorë si në vijim:

- Lidhet me mbetjet pasi ato janë prodhuar brenda një mjedisi të banuar dhe rregullojnë degradimin ose përmirësimin një totali rezidencial.
- Lidhet me zhurmat pasi në qytete ekzistojnë përdorime toke me funksione të tilla që gjenerojnë zhurma (si vendet e argëtimit, hapësirat prodhuese, arteriet rrugore, shërbimet publike). Aksi Prioritar parashikon përmirësimin e zhurmës brenda qytetit.
- Lidhet me popullsinë dhe me asetet e saj, pasi parashikon përmirësimin e kushteve të jetesës brenda në qytet dhe përmirësimin e ndërtesave domethënë të aseteve aktive të tyre.

- Lidhet me Peisazhin dhe konkretisht me Peisazhin urban, me ndërhyrje estetike dhe të efijensës energjetike në ndërtesa dhe në zonat e gjelbra të qyteteve dhe të vendbanimeve.
- Për sa i përket tokës, ajrit, faktorëve klimatikë, ujit, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore nuk është e mundur për tu përcaktuar ndikimi i Prioritetit 14 tek faktorët specifik mjedisor.

Tabela e më poshtme tregon lidhjen midis proriteteve të ndryshme të planit dhe parametrave Mjedisor:

Tabela 7. Tabela e Identifikimit të Ndikimeve Mjedisore për çdo Prioriteti dhe Faktori

Mjedisor (√: Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor, X: nuk ka efekt të Prioritetit në faktorin mjedisor).

	Toka	Ajri	Faktorët klimatike	Uji	Biodeve rsiteti	Mbetjet	Zhu rma	Popullsia dhe asetet materiale	Trashe gimia Kultur ore	Peizaz hi
Objektivi strategjik 1" Mbrojtja dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore "										
Prioriteti 1: Mbrojtja dhe menaxhimii qëndrueshëm i burimeve natyrore	√	√	√	√	√	√	X	√	X	√
Prioriteti 2: Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve pyjore	√	√	√	√	√	X	X	√	X	√
Prioriteti 3: Mbrojtja dhe menaxhimii qëndrueshëm i burimeve ujore	√	X	X	√	√	X	X	√	X	√
Prioriteti 4: Mbrojtje dhe përdorim i qëndrueshëm i tokës bujqësore	√	X	X	√	X	√	X	√	X	√
Prioriteti 5: Sensibilizimi mjedisor i	√	X	X	√	X	√	X	√	X	X

komunitetit lokal										
Objektivi strategjik 2" Rregullimi i infrastrukturës rrugore "										

Prioriteti 6: Zhvillimi turistik	√	√	X	√	X	√	√	√	√	√
Prioriteti 7: Modernizimi dhe rritja e prodhimit primar	√	√	X	√	X	√	√	√	√	√
Prioriteti 8: Përforcimi i prodhimit dhetësors dhe tregtisë	X	√	X	√	X	√	√	√	X	√

Objektivi strategjik 2 " Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Lipjanit "										
Prioriteti 9: Mbrojtja, promovimi dhe reklamimi i të gjitha monumenteve arkeologjike- kulturore të komunës	X	√	X	X	X	X	√	√	√	√
Prioriteti 10: Përforcim, zhvillim dhe shfrytëzim i vendeve kulturore dhe aktiviteteve të reja kulturore	X	√	X	X	X	X	√	√	√	√
Objektivi strategjik 4: " Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve "										

Prioriteti 11: Përmirësim/modernizim i rrjeteve të shërbimeve urbane në qytet dhe në vendbanimet e tjera, përmirësimi i infrastrukturës teknike mjedisore	√	X	X	√	√	√	X	√	X	
Prioriteti 12: Përmirësimi, modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të transportit	X	√	√	X	X	X	√	√	√	√
Prioriteti 13: Përmirësimi i infrastrukturës sociale në të gjithë vendin sipas nevojës	X	X	X	X	X	X	X	√	X	X
Prioriteti 14: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit të banimit/ndërtimet	X	X	X	X	X	√	√	√	X	√

9. PERCAKTIMI I OBJEKTIVAVE TE VSM-së

Objektivat e VSM-së janë përcaktuar në bazë të ligjeve, strategjive dhe planeve shtetërore dhe të BE-së; problemet mjedisore si pjesë e fushëveprimit të VSM-së kanë dhënë kontribut në

formulimin e objektivave të VSM-së. Ato janë diskutuar më tej në këtë raport. Objektivat mjedisore të këtij VSM-je janë përcaktuar duke i pasur parasysh objektivat e qëndrueshme zhvillimore të mjedisit, të përcaktuara në ligjet përkatëse, strategjitë dhe planet shtetërore të nivelit më të lartë. Janë marrë parasysh ligjet dhe strategjitë në vijim:

- Kushtetuta e vitit 2008
- Ligji nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor
- Ligji për ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 03/L-106, i miratuar nga Kuvendi më 10.11.2008, dhe i dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. DL-055-2008 më datën 17.11.2008, që ka hyrë në fuqi në ditën e botimit të tij në gazetën zyrtare nr. 42 të 25 (nëntor 2008, faqe 35-39).
- Ligji për Ndërtimin nr. 04/L-110 56 / 109
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit
- Ligji për Mbeturinat
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor
- Ligji për Rrugët (2003/11)
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji për Tokën Bujqësore (nr. 02/L-26)
- Ligji për Trashëgiminë Kulturore (nr. 02/L-88)
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (nr. 03/L-025)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (nr. 03/L-230)
- Ligji për Bujqësinë Organike (nr. 02/L-122)

- Strategjia mjedisore (2005-2015)²³
- Profili i planifikimit hapësinor²⁴
- Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin (2011-2020)
- Qasja strategjike në konferencën e Kopenhagës për ndryshimet klimatike, 2009

9.1. Problemet mjedisore dhe objektivat e VSM-së që rrjedhin prej tyre

Sipas kësaj që u tha më lartë janë identifikuar problemet mjedisore që ekzistojnë në komunë dhe të cilat shërbejnë për përpilimin e objektivave të VSM-së:

Tabela 8: Problemet më të rëndësishme mjedisore në komunë

Nr.	Përshkrimi
1	Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore
2	Indeksi i ulët i biodiversitetit
3	Mungesa e rrjetit ekologjik
4	Cilësi e pamjaftueshme e ajrit
5	Cilësi dhe sasi e pamjaftueshme e ujit
6	Menaxhim jo i duhur i ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta
7	Humbja e tokës me cilësi të lartë bujqësore për zgjerimin e vendbanimeve dhe zonave industriale
8	Dheu i degraduar për shkak të tokës së braktisur dhe/ose menaxhim i dobët i mbeturinave industriale (deponia e xeheve), mbeturinave ndërtimore dhe rrënojave, mbeturinave shëndetësore, dhe atyre komunale
9	Zbatim i pamjaftueshëm i VSM-së dhe VNM-së për zhvillimin e infrastrukturës dhe objekteve të reja
10	Emetimi i GHG prej trafikut dhe veprimtarive prodhuese
11	Urbanizimi i pakontrolluar dhe trafiku i ngjeshur
12	Mbrojtja e pamjaftueshme e trashëgimisë kulturore
13	Toka e degraduar e cila e zvogëlon vlerën e peizazhit rural
14	Mënyrë e jetesës e cila e neglizhon jetesën e shëndoshë dhe sjelljen miqësore ndaj mjedisit
15	Përfshirje e ulët shoqërore
16	Kapacitete të pamjaftueshme të objekteve të banimit
17	Varfëria

10.

MONITORIMI

10.1. Plani i Monitorimit

Objektivat dhe synimet i përcaktojnë synimet dhe pragjet që duhet të kihen parasysh kur evlerësojmë ndikimin e PZHK-së në mjedis. Treguesit janë përdorur për ta ilustruar ndikimin në mjedis në një mënyrë të thjeshtë dhe efektive. Treguesit e përzgjedhur do të përdoren për ta formuar bazën e programit të monitorimit për PZHK-në; shqyrtimi i radhës së PZHK-së do ta merr parasysh nivelin e përmbushjes së synimeve dhe treguesve të propozuar. Në këtë kapitull është përshkruar programi i propozuar i monitorimit. Qëllimi i treguesve është monitorimi e efikasitetit të PZHK-së në përmbushjen e objektivave dhe synimeve mjedisore të VSM-së. Metodologjia për zhvillimin dhe përzgjedhjen e treguesve të VSM-së është bazuar në:

- identifikimin e problemeve ekzistuese mjedisore, në bazë të të cilëve janë hartuar objektivat dhe treguesit e VSM-së
- Përzgjedhja e një numri të kufizuar, porse praktik të treguesve, kryesisht kualitativ, por edhe kuantitativ (aty ku ka qenë e mundur) në mënyrë që monitorimi të jetë i menaxhueshëm Përcaktimi i treguesve të përdorur në këtë raport është bazuar në vlerësimin e kontekstit dhe në procesin e analizës. Megjithatë, duhet të theksohet se përzgjedhja e fundit e tyre është ndikuar edhe nga treguesit ekzistues dhe relevant, programet aktuale të monitorimit si dhe shkallën e aplikimit. Aty ku nuk ka pasur të dhëna në dispozicion, njëra prej rekomandimeve të këtij raporti është të bëhen analiza shtesë (p.sh. studime) dhe të përmirësohet sistemi ekzistues i monitorimit.

Plani i monitorimit ka për synim të vlerësojë arritjet e objektivave mjedisore gjatë zbatimit të PZHK-së si dhe të ekzaminojë efektet mjedisore të masave lehtësuese të zbatuara. Në tabelën më poshtë janë paraqitur treguesit e propozuar për vlerësimin e suksesit të zbatimit të masave të rekomanduara lehtësuese. Kjo tabelë paraqet bazën e planit të monitorimit

Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e “Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe

me qëllim marrjen e masave rregulluese. Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AKMM Agjencisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal .

Mbështetur në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Lipjanit ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së. Këtu përfshihen qoftë Planet, projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i PZHK-së në Plane rregulluese për vendbanimet policentrike, lagje apo blloqe banimi.

Tabela 9. Plani i monitorimit

Aktiviteti	Periudha e monitorimit	Përgjegjës
Implementimi i standardeve dhe objektivave të parapara në këtë plan me rastin e ndërtimeve	Gjatë fazës së ndërtimit	Inspektorati i komunës Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis
Implementimi masave të parapara me këtë plan, si dhe i projekteve të Ndikimin më Mjedis(VNM) me rastin e planifikimit dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore	Gjatë fazës së planifikimit dhe ndërtimit	Drejtoria për Urbanizëm Planifikim Vlerësimit të dhe Mjedis Inspektorati i Komunës Inspektorati i MMPHI
Planifikimi dhe instalimi i infrastrukturës së shërbimeve publike	Gjatë fazës së ndërtimit Mirëmbajtja në mënyrë të vazhdueshme	Drejtoria e Shërbimeve publike. Kompania rajonale e ujësjellësit
Menaxhimi i mbeturinave	Në mënyrë të vazhdueshme	Kompania për menaxhimin e mbeturinave Drejtoria e Shërbimeve Publike Inspektorati komunal

<i>Shkarkimi i ujërave të zeza</i>	<i>Në mënyrë të vazhdueshme</i>	<i>Kompania rajonale e ujësjellësit</i>
<i>Ciëlsia e ajrit</i>	<i>Vleresime te kohëpaskohëshme</i>	<i>Drejtoria e Shërbimeve publike Inspektorati i mjedisit Agjencia për Mbrojtjen e mjedisit (AMMK) Drejtoria e Shërbimeve publike</i>

11.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky vlerësim strategjik mjedisor (VSM) i analizon efektet mjedisore të planit zhvillimor komunal (PZHK) të komunës dhe i ofron disa rekomandime për administratën komunale se si të integrojë problemet mjedisore në zbatimin e planit.

Procesi i VSM-së u realizua paralelisht me hartimin e PZHK-së me qëllim që të sigurohet që çështjet mjedisore të integrohen në PZHK për ta mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm edhe në aspektin mjedisor.

Komuna e është e rrethuar me komuna tjera dhe ka potencial për zhvillim është afer komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit dhe aeroportit . Mbizotëron një klimë kontinentale me vera të nxehta dhe të thata si dhe me dimra mjaft të ftohtë.

Sipas Planit Hapësinor për Kosovën (2010 – 2020) komuna i takon zonës së caktuar për zhvillim të intensifikuar ekonomik për shkak të afërsisë mjaft të madhe me kryeqytetin Prishtinën.

Toka bujqësore, uji dhe xehet janë resurset më të rëndësishme në komunë. Kur bie fjala për resurset minerale, atëherë duhet të merren parasysh pasojat mjedisore. presionit ekzistues mjedisor që vjen nga rrjedhja dhe erozioni i deponisë së xeheve të minierës si dhe nga mosmirëmbajtja e duhur minierës.

Edhe pse ajo ka tokë bujqësore me cilësi të lartë, ekzistojnë presione të ndryshme për ndërrimin e destinimit të saj për qëllime jo produktive. Cilësia e dheut nuk është studiuar sa duhet në këtë komunë. Mbrojtja e tokës bujqësore bashkë me ruajtjen e dheut të cilësisë së lartë duhet të jenë ndër prioritetet më të rëndësishme të komunës. Nuk duhet të lejohen aktivitetet ndërtimi në toka të Klases I-IV.

Burimet e ujit egzistues (resurset ujore) duhet të mbrohen sipas ligjeve në fuqi dhe UA për resurs ujore

Burimet e ujit nuk janë hulumtuar sa duhet: nuk ka të dhëna sa i përket sasisë mesatare, maksimale dhe minimale të lumenjve, e as nuk ka informata për rezervat e ujërave nëntokësore (thellësia e ujit, sasia, shkarkimi, etj.). Duhet të bëhen analiza të mëtejme me qëllim që të përkufizohen si duhet politikat e furnizimit me ujë dhe të ujitjes në të ardhmen në komunë.

Resurs ujor që gjenden në komune duhet të mbrohen në baze të ligjeve në fuqi.

Përveç kësaj, është me rëndësi edhe njohuria për hidrologjinë e lumenjve për të vendosur për metodat më të mira të rregullimit të lumenjve si pjesë të politikave të ardhshme sa i përket mbrojtjes nga vërshimet. Vetëm pas një studimi për burimet e ujit, komuna mund të vendos për mënyrën më të mirë të sigurimit të burimeve të furnizimit me ujë dhe për ujitje.

Burimet biologjike janë te ndryshme : pyje të kufizuara dhe jo shumë të vlefshme në aspektin ekonomik, stoqet në rënie të peshkut për shkak të cilësisë së dobët të ujit të lumenjve, mungesa e monitorimit dhe mbrojtjes së kafshëve të egra edhe përkundër planeve të komunës për krijimin e rezervateve të gjuetisë; kjo nënkupton se komuna duhet të punojë në restaurimin e burimeve biologjike në mënyrë të organizuar

Zyrtarisht, numri më i madh i njerëzve të punësuar në komunë janë në sektorin publik, shumica në arsim, shëndetësi dhe administratë komunale – të radhitura sipas numrit të të punësuarve.

Objektet për ofrimin e shërbimeve publike (kujdesi shëndetësor, arsimi, etj.) janë të degraduara dhe kërkojnë rinovim i menjëhershëm. Ka një deficit të banimit të cilin komuna synon ta adresojë përmes zgjerimit të kufijve të vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimeve të reja.

Një numër i kufizuar i qytetarëve punon në sektorin privat. Ndërmarrësia nuk është zhvilluar në shkallë të mjaftueshme po ashtu ka shumë depo që i mbështesin aktivitetet tregtare.

Zonat e biznesit/ industriale nuk janë të organizuara si duhet dhe u mungon infrastruktura e duhur rrugore dhe komunale.

Objektivat e PZHK-së janë testuar gjatë procesit të VSM-së nëse përkojnë me objektivat mjedisore. Janë identifikuar raporte sinergjike në shumicën e objektivave të PZHK-së. Shumica e fushave konfliktuale mes objektivave të PZHK-së dhe VSM-së janë në sektorët ekonomik dhe të infrastrukturës, kryesisht në kategoritë e mëposhtme të shfrytëzimit të tokës:

- Përmirësimi i zhvillimit të bizneseve (industriale, depove, minierave, etj.) përmes krijimit të zonave të reja dhe/ose zgjerimit të atyre ekzistuese;
- Përcaktimi i zonave për turizëm, trashëgimi kulturore dhe peizazhe natyrore, peshkim, gjueti dhe aktivitete të tjera plotësuese komerciale;
- Ngritja e ndërtesave dhe qarqeve të reja, qofshin ato të banimit, administrative, të kujdesit shëndetësor, sportit, kulturës ose të tjera;
- Ndërtimi i infrastrukturës: rrugë/ hekurudha, furnizim me ujë (duke përfshirë penda, rezervarë, gypa) / pastaj kanalizim, impiante për trajtimin e ujërave të zeza, impiante për trajtimin e mbeturinave dhe deponive të mbeturinave, linja mbitokësore të rrymës elektrike, kabllo optike, furnizim me gaz natyror përmes gypave, etj.
- Çfarëdo shfrytëzimi i tokës që e ndryshon peizazhin natyror në tokë ndërtimore mund ta prish mjedisin, nëse nuk zbatohen masa parandaluese.

Raporti i VSM-së e thekson evolucionin e skenarit duke marrë parasysh:

- Trendët demografike do të vazhdojnë me shkallën aktuale të rritjes, e cila do të bëjë presion tek burimet natyrore dhe fizike; së këndejmi, do të ketë mungesë të ujit dhe burimeve të tjera;
- Trafiku i ngjeshur si dhe ndërtimi i pakontrolluar do të shtohen; zhurma do të ndikojë negativisht tek dëgjuesit e saj dhe bota e egër shtazore (që strehohet në tokat bujqësore, terrenet përreth brigjeve të lumenjve si dhe në pyjet e degraduara
- Vendbanimet do të zgjerohen në mënyrë të planifikuar dhe do të krijohen grupe të tyre përreth korridoreve më të frekuentuara të transportit;
- Tokat bujqësore do të zvogëlohen sipas planit ne investimet ne energjin e ripertishme por duhet të mos lejohet ne tokat te klases I-IV por te shrytezohen zona pyjore me shkurra ose tokat e klase V-VI; zonat e biznesit/ industrial do t'i zëvendësojnë kulturat bujqësore, ndërsa cilësia e dheut do të

degradohet si pasojë menaxhimit jo të duhur të ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta, si dhe do të ketë rritje të plehut artificial dhe pesticideve; po ashtu do të ketë më pak pleh organik krahas zvogëlimit të numrit të bagëtive nese nuk investohet ne stimulumne e keti sektori

- Deponitë e paligjshme të mbeturinave do të përhapen edhe më shumë si rezultat i moszbatimit të duhur të ligjit;

- Cilësia e lumenjve do të degradohet për shkak të shkarkimit të vazhdueshëm të ujit të patrajtuar nga shtëpitë dhe objektet komerciale/industriale, si dhe nga rrjedhja e metalit të rëndë dhe erozionit nga deponia e xeheve ; bota e egër që jeton në ujë do të jetë në rrezik të shfarosjes;

- Ndotja e grumbulluar nga miniera do ta përkeqësojë edhe më tej cilësinë e ajrit, ujit dhe dheut, dhe do të ketë ndikim negativ në shëndetin e njeriut;

- Trashëgimia kulturore nuk do të mbrohet sa duhet gjë që do të rezultojë në humbjen e vlerave të prekshme dhe të paprekshme të saj;

- Biodiversiteti do të degradohet për shkak të prerjes së paligjshme dhe të pakontrolluar të drunjve, gjuetisë, peshkimit, zgjerimit të aktiviteteve ekonomike dhe ndërtimore dhe ndotjes që vijnë prej tyre;

- Cilësia e jetës do të përkeqësohet në mungesë të zonave të mjaftueshme të banimit, peizazheve tërheqëse, hapësirave të hapura, parqeve, korridoreve natyrore përgjatë brigjeve të lumit dhe që ndihmojnë në zvogëlimin e zhurmës së linjave të transportit, etj.

- Ndryshimi i klimës do të shkaktojë fenomene ekstreme (vërshime dhe thatësira).

Më tej, raporti i VSM-së i paraqet pasojat mjedisore të tre skenarëve zhvillimorë të PZHK-së: skenarin e trendit, të përqendrimit dhe të decentralizimit. Secili prej skenarëve përmban propozime të mira, të cilat u diskutuan nga pikëpamja mjedisore. Këta skenarë pastaj janë testuar kundrejt parimeve të qëndrueshmërisë dhe të objektivave mjedisore. Këto analiza kanë kontribuar në identifikimin e efekteve më të mundshme mjedisore që rrjedhin nga korniza zhvillimore e planifikimit dhe masat e propozuar në të.

VSM si perfundim PZHK si dokument i shkruar paraqet dhe permbush kritere Mjedisore por realizimi i tij vlen per te deshiruar per shka te mungeses se budgjetit dhe ndarjes se buxhetit sidome per prioritet mjedisore ku mungojn planet per mbrojtje te mjedisit qe jane te parapar si obligime dhe detyrat e Komunes per menagjim dhe mbrojte te mjedist ne nivel Lokal.

Ato jan Plani lokal i VM, Plani lokal per Biodiversitet, Plani lokal i V per Cilesi te Ajrit, Plani lokal i V i mobiltteti

LITERATURA

1. Planit Hapësinor të Kosovës-Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+”,
2. Ligji iVSM
3. **LIGJI NR. 08/L-181 VNM**
4. Ligji i mbrojtjes se Mjedisit
5. VSM i HZ
6. Plani Rregullues Urban.
7. American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010.
8. Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998.
9. Ernest A. Loëe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries.
10. Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2010.
11. Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
12. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia për Mjedisin 2013-2022). Prishtinë, 2013.
13. Komuna e Lipjanit , Hartat e prezantuar në HZK.
14. Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë;
15. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
16. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;
17. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC.
18. Draft Plani Zhvillimor i Komunës së Lipjanit 2023 -2032;
19. Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisin 2013-2022). Prishtinë, 2013.
20. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
21. Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor;
22. Plani Lokal i Veprimit Lokal në Mjedis 2012 – 2017.
23. Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave 2016-2021.
24. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve (2009).
25. Raport I Hospoteve Mjedisore nw Kosove, 2012;
26. Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2021;
27. Zonat të mbrojtura në Kosovë
28. VSM per HZK 2019
29. Draft I PZHK 2023-2031